

RAPORT

I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Për Programin e studimit “Master Profesional” në
“Financë-Kontabilitet”, ofruar nga KOLEGJI UNIVERSITAR**

“LOGOS”

Ekspertë të vlerësimit të jashtëm:

Prof. As. Dr. Etleva Bajrami

Dr. Valbona Kapllani

Qershor, 2018

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Master Profesional në "Financë – Kontabilitet"

Tabela e të dhënave të licencimit për programin e studimit:		
1	IAL Aplikues:	Kolegji Universitar "LOGOS"
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti Ekonomik
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	<i>Urdhër Nr. 335, datë 16.08.2013 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës¹</i> Urdhër Nr. 428, datë 22.09.2017 i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë²
4	Titulli i programit të studimit:	Master Profesional në "Financë - Kontabilitet"
5	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
6	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit akademik
7	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
8	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
9	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
10	Programi ofrohet nga institucioni	Po
11	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	Jo
12	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
13	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
14	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 7
15	Aktivizimi i programit të studimit	2013-2014 (Programi 90 ECTS) 2017-2018 (Programi 60 ECTS)
16	Brezi i parë i diplomimit të studentëve	2014-2015 (Programi 90 ECTS) 2017-2018 (Programi 60 ECTS)
17	Numri i studentëve	<i>9 studentë, Viti I</i> <i>0 studentë, Viti II</i> <i>(viti akademik: 2013-2014, programi 90 ECTS)</i> <i>16 studentë, Viti I</i> <i>9 studentë Viti II</i> <i>(viti akademik: 2014-2015, programi 90 ECTS)</i> <i>17 studentë, Viti I</i> <i>15 studentë, Viti II</i> <i>(viti akademik: 2015-2016, programi 90 ECTS)</i> <i>0 studentë, Viti I</i> <i>16 studentë, Viti II</i> <i>(viti akademik: 2016-2017, programi 90 ECTS)</i> 7 studentë, Viti I (viti akademik: 2017-2018, programi 60 ECTS)

¹ Programi është hapur me Urdhër Nr. 335, datë 16.08.2013 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, dhe është ofruar me 90 kredite (ECTS), me kohëzgjatje normale 1.5 vite akademike.

² Programi është riorganizuar me Urdhër Nr. 428, datë 22.09.2017 i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, dhe që nga viti akademik 2017-2018 ofrohet me 60 kredite (ECTS), me kohëzgjatje normale 1 vit akademik.

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit

Programi Master Profesional në “Financë - Kontabilitet” organizohet nga Fakulteti Ekonomik, Kolegji Universitar “LOGOS”, i cili është licencuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 1055, datë 29.07.2009. Në këtë vendim përcaktohet se KU “LOGOS” do të organizohet në dy fakultete, në Fakultetin Ekonomik dhe Fakultetin e Shkencave të Aplikuara.

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës me Urdhër nr. 396 datë 02.08.2010, lejon ushtrimin e veprimtarisë akademike në përputhje me licencën e dhënë për hapjen e Shkollës së Lartë Private “LOGOS”.

Me Urdhër Nr. 1, datë 06.01.2011 të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës (MASH), pranë Shkollës së Lartë Private “LOGOS”, hapen programe të reja të studimit të ciklit të parë: Financë Kontabilitet, Menaxhim Biznesi dhe Teknik i Lartë Laboratorësh Mjekësor. Me Urdhër Nr. 481, datë 03.10.2011, MASH lejoi ushtrimin e veprimtarisë akademike në përputhje me licencën e dhënë për hapjen e programeve të reja të studimit si më lartë.

Me Urdhër Nr. 282, të datës 04.07.2012 Ministria e Arsimit dhe e Shkencës urdhëron Akreditimin institucional të Shkollës së Lartë Private “LOGOS”, dhe Akreditimin e programeve të studimit të ciklit të parë në përfundim të të cilëve lëshohet diplomë “Bachelor”.

Me Urdhër Nr. 335, datë 16.08.2013 të Ministrisë së Arsimit është hapur programi i studimeve të ciklit të dytë Master Profesional në “Financë Kontabilitet”, në përputhje me vendimin nr. 524, datë 18.07.2013 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë. Sipas Pikës 2 të këtij Urdhëri, programi realizohet me 60-90 kredite, me kohëzgjatje normale 1.5 vite akademike.

Masteri Profesional në “Financë Kontabilitet”, i ofruar nga Institucioni me 90 ECTS dhe kohëzgjatje normale 1.5 vite akademike, është akredituar me kusht me Urdhër MAS Nr. 342, datë 17.09.2015, në bazë të Vendimit Nr. 69, datë 27.07.2015 të Këshillit të Akreditimit.

Sipas Urdhrit të MAS Nr. 606, datë 22.12.2016, KU “LOGOS” i ka plotësuar kushtet e vendosura për Akreditimin e Masterit Profesional në “Financë Kontabilitet”, në bazë të Vendimit Nr. 211, datë 18.11.2016 të Këshillit të Akreditimit.

Masteri Profesional në “Financë Kontabilitet” është akredituar që të realizohet me 90 kredite dhe me kohëzgjatje 1,5 vite akademike (3 semestra).

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë me Urdhër Nr. 428, datë 22.09.2017 urdhëron riorganizimin e Masterit Profesional në “Financë Kontabilitet”, në Fakultetin Ekonomik të Kolegjit Universitar “LOGOS”, Tiranë. Ky urdhër është në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 35, pika 1 të Ligjit Nr 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Masteri Profesional në “Financë Kontabilitet” me 90 kredite dhe me kohëzgjatje 1,5 vite akademike (3 semestra) urdhërohet të riorganizohet në 60 kredite, në gjuhën shqipe, me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 1 vit akademik (2 semestra) në përfundim të të cilëve të lëshohet diplomë Master Profesional në “Financë-Kontabilitet”, në Fakultetin Ekonomik, të Kolegjit Universitar “LOGOS”, Tiranë.



Po në Urdhrin e riorganizimit me Nr. 428, datë 22.09.2017 kërkohet që Kolegji Universitar "LOGOS", t'i nënshtrohet procesit të akreditimit për Masterin Profesional në "Financë Kontabilitet".

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

1. Prof. As. Dr. Etleva Bajrami
2. Dr. Valbona Kapllani

Gjatë gjithë procesit të vlerësimit GVJ u asistua nga Kordinatori Teknik i ASCAL, znj. Emisa Isufaj.

Më datë 11.06.2018, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare me Nr. 26/12 Prot., datë 11.06.2018 me lëndë "Dërgohen Draft-Raportet e Vlerësimit të Jashtëm", KU "LOGOS" është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. Më datë 22.06.2018, KU "LOGOS" përcjell nëpërmjet sistemit AMS në ASCAL "Përgjigjet për Draft Raportet e Vlerësimit të Jashtëm për programet e studimeve MP në Financë Kontabilitet dhe MP në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë", ndërsa me shkresë Nr.61/1 Prot., datë 22.06.2018 me lëndë "Dërgohen komentet rreth Draft Raporteve të Vlerësimit të Jashtëm" ato sillen zyrtarisht. Në shkresën për përgjigjen mbi draft Raportin për programin "Master Profesional" në "Financë-Kontabilitet", hartuar nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB), ky i fundit shprehet se anëtarët janë plotësisht dakord me Draft-Raportin e përgatitur dhe nuk kanë asnjë koment. Si përfundim, raporti i vlerësimit të jashtëm **nuk u ndryshua.**

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkimore

Misioni i KU "LOGOS" është t'u japë studentëve dije dhe njohuri bazë mbështetur në metodat dhe parimet shkencore të përgjithshme, të ofrojë mundësi për të përfituar nga arsimi i lartë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës, të kontribuojë në mbështetje të prioriteteve strategjike dhe interesave të përgjithshme të vendit si dhe të integrojë mësimdhënien me kërkimin shkencor. Nëpërmjet programeve të studimit mundësohet kompletimi i të diplomuarve me aftësi dhe kompetenca konkrete sipas llojit të profesionit dhe që karakterizojnë profilin edukativo-kulturor dhe profesional të çdo programi studimi që ofron.

Misioni i programit Master Profesional në "Financë-Kontabilitet" është në një drejtim me misionin kryesor të institucionit, sepse synon t'u ofrojë studentëve të diplomuar arsimim dhe trajnim të mirëfilltë profesional.

Qëllimi i KU "LOGOS" është të përgatisë specialistë të lartë me dije të nivelit bashkëkohor në programet e studimit dhe profilet përkatëse të miratuara, të kryejë studime dhe kërkime shkencore në fushat dhe sektorët që mbulon në bashkëpunim me institucione homologe e sipërmarrje private. Gjithashtu qëllimi i KU "LOGOS" është të hyjë në marrëdhënie bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit.

Objektivat kryesore të programit Master Profesional në "Financë-Kontabilitet" synojnë të ngrenë në një nivel cilësor më të lartë njohuritë profesionale dhe shkencore që janë fituar paraprakisht nga studentët në nivelin "Bachelor". Duke qenë një Master Profesional në "Financë-Kontabilitet", një nga objektivat më të rëndësishëm është përgatitja e specialistëve të aftë në trajtimin e problematikave financiare dhe kontabël që mund të shfaqen në biznese të ndryshme. Çdo kompani e madhe apo e

vogël qoftë në përmasa e ka të nevojshëm specialistin e financës dhe kontabilitetit dhe objektivi i këtij programi i vjen në ndihmë çdo biznesi. Ky Master nëpërmjet programit të tij synon krijimin e ekspertëve financiarë dhe kontabël aq shumë të nevojshëm për tregun shqiptar në kushtet e adaptimit të bizneseve shqiptare me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit. Ky program përgatit specialistë tatim taksash dhe auditues jo vetëm për sektorin privat, por edhe për sektorin publik.

Strategjia e KU “LOGOS” mbështetet në ligjin për arsimin e lartë dhe është në pajtueshmëri të plotë me prirjet kryesore të zhvillimit të arsimit të lartë në nivel ndërkombëtar. Autonomia dhe liria akademike ndihmojnë institucionin në veprimtarinë e tij duke sjellë literaturë bashkëkohore për të marrë eksperiencat më të mira europiane.

Strategjia e institucionit si afatshkurtër dhe afatgjatë për rritjen e cilësisë vë në fokus cilësinë e mësimnxënies dhe mësimdhënies, duke vënë në qendër studentin me mësimdhënien dhe shërbimet që i ofrohen atij. Kjo realizohet me programet që ofrohen dhe syllabusat përkatës. Institucioni synon të ofrojë edhe ambiente dhe kushte të përshtatshme për studentët dhe stafin akademik. Në strategjinë e institucionit është rekrutimi i një stafi profesional, i cili të hartojë dhe zbatojë programet me metodat bashkëkohore, duke synuar afrimin pranë institucionit të akademikëve me grada shkencore dhe tituj akademikë.

Institucioni ka si strategji afatmesme dhe afatgjatë rishikimin e vazhdueshëm të programeve në mënyrë që të jenë sa më bashkëkohor. Gjithashtu, në strategjinë afatmesme dhe afatgjatë të institucionit është rritja e nivelit të mësimdhënies. Kjo kërkon që stafi të bashkëpunojë fort me institucionin për metodat e përdorura në mësimdhënie. Gjithashtu institucioni ka si synim rritjen e kualifikimit të personelit akademik aktual nëpërmjet kualifikimeve dhe botimeve shkencore, pjesëmarrjes në konferenca dhe projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në strategjinë e institucionit është edhe nxitja e bashkëpunimeve me institute të arsimit të lartë kombëtare dhe ndërkombëtarë për rritjen e cilësisë së mësimdhënies me anë të shkëmbimit të eksperiencës si dhe bashkëpunime të ndryshme. Gjithashtu KU “LOGOS” synon rritje të bashkëpunimit me biznese dhe institucione të ndryshme për të qenë më pranë tregut të punës, duke mundësuar lehtësi për praktikantët e studentëve dhe kryerjen e mikrotezave duke mundësuar edhe përgatitje profesionale.

Që në aktin e themelimit KU “LOGOS” ka përcaktuar karakterin akademiko-mësimor dhe është jofitimprurës. Kjo strategji realizohet nëpërmjet tarifave dhe bursave që ofrohen për studentët.

Programi i Master Profesional në “Financë-Kontabilitet” i referohet nivelit të 7-të të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe organizohet me 60 kredite europiane (ECTS). Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë “Master Profesional” në fushën e Financë-Kontabilitetit, shoqëruar me suplementin e diplomës. Emërtimi i programit të studimit përputhet me fushën e studimit.

Për t’u pranuar në programin e studimeve Master Profesional në “Financë-Kontabilitet”, kandidatët duhet të kenë përfunduar studimet në një program të ciklit të parë dhe të plotësojnë kriteret e pranimit të vendosura nga njësia bazë që ofron programin.


Në kuadrin e bashkëpunimit me Universitete të tjera, KU “LOGOS” ka lidhur Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin e Pireut të Greqisë me seli në Pire. Marrëveshja synon zhvillimin e një bashkëpunimi akademik në fushat e edukimit, formimit teoriko-profesional, të kërkimit shkencor si dhe në fusha të tjera që ka interes të vecantë.



Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve³
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p>	<p>Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit. Programi “Master Profesional” në Financë-Kontabilitet është në një drejtim me misionin kryesor të institucionit. Masteri Profesional synon t’u ofrojë studentëve të diplomuar arsimim dhe trajnim të mirëfilltë profesional, konkretisht në Financë-Kontabilitet. Këtë e mundësojnë veçanërisht lëndët si Kontabilitet financiar i avancuar, Buxheti dhe Analiza financiare dhe Taksim. Misioni i KU “LOGOS” është t’u ofrojë studentëve të diplomuar arsimim dhe trajnim të mirëfilltë profesional.</p> <p>Qëllimi i KU “LOGOS” është t’u japë studentëve dije dhe njohuri bazë mbështetur në metodat dhe parimet shkencore të përgjithshme, të ofrojë mundësi për të përfutuar nga arsimi i lartë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës, të kontribuojë në mbështetje të prioriteteve strategjike dhe interesave të përgjithshme të vendit si dhe të integrojë mësimdhënien me kërkimin shkencor.</p> <p>Institucioni ka kryer anketim me pyetësor të studentëve në proces diplomimi apo të diplomuar në nivelin e studimeve Bachelor dhe ka rezultuar se rreth 80 përqind e tyre kanë shprehur interes për këtë program studimi. Gjithashtu institucioni nëpërmjet bashkëpunimeve me biznese të ndryshme ka perceptuar dhe kuptuar nevojat e tyre për specialistë finance dhe kontabiliteti. Institucioni ka organizuar takime me punëdhënës jo vetëm për të kuptuar nevojat e tyre, por edhe me synimin e punësimit të studentëve. Me anë të strukturave të Alumni institucioni mban lidhje me studentët e diplomuar, të cilët organizojnë takime me tregun e punës. Informacioni i marrë nga studentët e diplomuar është një mënyrë e mirë për të njohur tregun e punës nga ana e institucionit dhe përfshirjen e këtij informacioni në programet e studimit. Në planet afatshkurtra të institucionit ishte edhe hapja e Zyrës së tregut të punës, e cila do ndihmojë studentët për punësim dhe do jetë</p>

³ GVJ duhet të shprehen me shkrim për çdo standard në mënyrë të përmbledhur (mbështetur në kriteret majtas). Në fund të çdo rubrike, grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardeve në tërësi.



<p>Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>Instituti bashkëpunon me biznese dhe institucione të ndryshme duke qenë pranë tyre dhe siguron edhe informacionin në lidhje me ecurinë ekonomike të vendit. Stafi akademik realizon punime shkencore dhe studentët mikroteza nga sfera të ndryshme të ekonomisë. Lëndët që ofrohen, me rishikimin e vazhdueshëm të programit, mundësojnë pasqyrimin e zhvillimit ekonomik dhe adaptimin e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit, të cilat trajtohen në lëndën Kontabilitet financiar i avancuar. Ndërkohë që ndryshimet e vazhdueshme të legjislacionit tatimor shqiptar i cili i përshtatet zhvillimit ekonomik të bizneseve dhe të vendit ju ofrohen studentëve nëpërmjet lëndës Taksim.</p> <p>Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit. Në statutin e institucionit përcaktohet qartë se baza e mësimdhënies dhe e kërkimit shkencor janë traditat më të mira morale kulturore, historike, arsimore dhe shkencore të vendit.</p>
<p>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Strategjia e institucionit për zhvillim synon rritjen e cilësisë së brendshme. Strategjia vë në fokus cilësinë e mësimdhënies dhe mësimdhënies. Strategjia e institucionit synon rritjen e nivelit të mësimdhënies. Kjo realizohet me programet që ofrohen dhe syllabusat përkatës.</p> <p>Institucioni e ka strategji rishikimin e vazhdueshëm të programeve në mënyrë që të jenë sa më bashkëkohore. Programet e studimit rishikohen jo vetëm nga përmbajtja por edhe në metodikë që të jenë sa më bashkëkohore. Në strategjinë për zhvillim të institucionit synohet rritja e numrit të studentëve dhe ofrimi i Programit të studimit Programi “Master Profesional” në Financë-Kontabilitet kontribuon për këtë pasi është një ndër programet më të kërkuara nga studentët, bazuar kjo edhe në anketën e zhvilluar nga institucioni.</p>
<p>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p>	<p>Studenti që ndjek programin e “Master Profesional” në “Financë-Kontabilitet”, e zhvillon atë në kohëzgjatjen prej 1 (një) viti akademik dhe fiton 60 kredite. Kjo është në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë nr. 80/2015, me synim krijimin e mundësive për mobilitet dhe transferim të tyre nga njëri institucion i arsimit të lartë në tjetrin, brenda</p>

<p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>dhe jashtë vendit. KU "LOGOS" funksionon në bazë të ligjit të sipercituar dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore të këtij ligji.</p> <p>Masteri Profesional në "Financë-Kontabilitet" është i organizuar në 60 kredite, në gjuhën shqipe, me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 1 vit akademik (2 semestra), në përfundim të të cilëve të lëshohet diplomë Master Profesional në "Financë-Kontabilitet", në Fakultetin Ekonomik, të Kolegjit Universitar "LOGOS", Tiranë.</p> <p>Programi i Master Profesional në "Financë-Kontabilitet" i referohet nivelit të 7-të të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe organizohet me 60 kredite europiane (ECTS). Në përfundim të këtij program studimi lëshohet diplomë "Master Profesional" në fushën e Financë Kontabilitetit, shoqëruar me suplementin e diplomës.</p>
<p>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>Institucioni ka të hartuar një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve. Strategjia e institucionit për rritjen e cilësisë së brendshme vë në fokus cilësinë e mësimdhënies dhe mësimdhënies. Kjo realizohet me programet që ofrohen dhe syllabusat përkatës. Strategjia e institucionit është rishikimi i vazhdueshëm i programeve në mënyrë që të jenë sa më bashkëkohore.</p> <p>Meqënëse strategjia e institucionit është rritja e nivelit të mësimdhënies në planin strategjik synohet një staf akademik profesional i cili të hartojë dhe zbatojë programet me metodat bashkëkohore.</p> <p>Gjithashtu për këtë qëllim institucioni ka si synim në planin strategjik rritjen e kualifikimit të personelit akademik aktual nëpërmjet kualifikimeve dhe botimeve shkencore, pjesëmarrjes në konferenca dhe projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Për realizimin e misionit të vet për përgatitjen e studentëve me njohuri të thelluara teorike dhe praktike, Fakulteti Ekonomik ka hartuar plan strategjik për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe mësimdhënies.</p> <p>Kështu, në planin afatshkurtër i jepet rëndësi zhvillimit me efektivitet të orës së mësimt. Përcaktohen qartë mënyra e zhvillimit e mësimt, orët e leksionit, seminarët, diskutimet për literaturë të marra nga interneti, etj.</p>

Përdoret mënyra e mësimdhënies interaktive ku kombinohet sinjali viziv me atë akustik, nëpërmjet paraqitjes së leksioneve në Poëer Point.

Sigurohet lidhja logjike ndërmjet temave në programet e lëndëve të ndryshme. Stimulohet puna e pavarur nëpërmjet tematikave që zhvillohen në orët e seminareve. Ftohen ekspertë të fushës, të cilët me anë të eksperiencës rrisin cilësinë e të mësuarit.

Në planin afatmesëm dhe afatgjatë synohet të përfitohen eksperiencia të reja nga bashkëpunime të ndryshme me Universitete të huaja dhe vendase, si dhe fokusi vihet në trajnimin dhe kualifikimin e stafit akademik.

Në planin afatgjatë synohet ofrimi i bibliotekës online për studentët, duke synuar edhe përdorim të saj për zhvillim leksionesh apo diskutim të problematikave online. Integrimi i syllabuseve me njëri tjetrin në mënyrë që dijet e studentit të rriten në mënyrë integrale dhe ai të mundet të realizojë analiza të problematikave të ndryshme.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Programi i studimit “Master Profesional” në “Financë-Kontabilitet” është në të njëjtin drejtim me misionin kryesor të institucionit. Misioni i KU “LOGOS” është t’u ofrojë studentëve të diplomuar arsimim dhe trajnim të mirëfilltë profesional.
2. Strategjia e institucionit është rritja e nivelit të mësimdhënies. Strategjia e institucionit sikurse misioni, realizohet me programet që ofrohen, syllabusat përkatës dhe përdorimin e metodave bashkëkohore të zhvillimit.
3. Strategjia e institucionit si afatshkurtër dhe afatgjatë për rritjen e cilësisë së brendshme vë në fokus cilësinë e mësimdhënies dhe mësimdhënies, duke zhvilluar metoda interaktive të mësimit dhe duke vënë në qendër studentin. Marrëveshjet me universitete të huaja, me biznese vendase dhe leksionet e hapura nga ekspertë të fushës kontribuojnë në realizimin e strategjisë.
4. Instituti bashkëpunon me biznese dhe institucione të ndryshme, siguron informacion në lidhje me ecurinë ekonomike të vendit dhe nevojat e punësimit. Lëndët që ofrohen, me rishikimin e vazhdueshëm të programit, mundësojnë pasqyrimin e zhvillimit ekonomik.

Për sa është shpjeguar më sipër, konkludojmë që standardet në çështjen 1 “Misioni/Objektivat e programit të studimit” përmbushen plotësisht.

2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Masteri Profesional në "Financë-Kontabilitet" ofrohet nga Departamenti Financë Kontabilitet i Fakultetit Ekonomik.

Fakulteti Ekonomik, si njësi kryesore përbëhet nga tre departamente:

- Departamenti Financë Kontabilitet,
- Departamenti Menaxhim Biznesi,
- Departamenti Menaxhim Turizëm.

Departamenti i Financë Kontabilitetit ka ngritur Këshillin Shkencor, i cili përbëhet nga 3 anëtarë me grada/tituj shkencore. Këshilli Shkencor drejtohet nga Koordinatori i Masterit Profesional në "Financë-Kontabilitet". Koordinatori prezanton studentët me rregulloren, kriteret e pranimit, planin dhe programet mësimore, rregullat e vlerësimit, praktikës, diplomimit, etj.

Stafet e departamenteve kanë CV të pasur ku vihen re gradat/titujt. Lëvizja e stafit nuk është e shpeshtë dhe kur ndodh ka ndodhur me zgjedhjen nga ana e stafit për t'u larguar në raste të avancimit të karrierës së tyre në vijim. Aktualisht, Fakulteti Ekonomik po finalizon rekrutimin e një pedagogu në Departamentin e Menaxhim Turizmi për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe për plotësimin e numrit minimal të lejueshëm ligjor prej 7 anëtarësh të çdo departamenti.

Dekani i Fakultetit Ekonomik është z. Guxim Kola Phd, por mban edhe pozicionin e Përgjegjës të Departamentit Menaxhim Turizëm deri në zgjedhjet e ardhshme, të cilat gjatë vizitës na u tha që do të zhvilloheshin në pjesën e dytë të këtij viti.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Fakulteti, Organizimi hierarkik i Fakultetit
- Struktura akademike e Fakultetit

Autoritetet drejtuese akademike janë:

- Rektori i institucionit
- Dekani
- Përgjegjësi i Departamentit

Autoritetet drejtuese administruese janë:

- Administratori i KU "LOGOS"

KU "LOGOS" përbëhet nga njësitë kryesore, njësitë bazë dhe njësitë ndihmëse si më poshtë:
Fakultetet:

1. Fakulteti Ekonomik
2. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara

1. Fakulteti Ekonomik
 - Departamenti Financë Kontabilitet
 - Departamenti Menaxhim Biznesi
 - Departamenti Menaxhim Turizëm.

2. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara
 - Departamenti Teknik e Lartë në Laboratorë Mjekësorë
 - Departamenti Informatikë e Zbatuar

— Qendra e Kërkimit dhe Zhvillimit

Njësitë ndihmëse:

- Sekretaria Mesimore
- Biblioteka
- Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivi
- Zyra e Kërkimit shkencor dhe e marrëdhënieve me jashtë
- Zyra e Financës dhe shërbimeve
- Zyra e NJSBC
- Zyra e këshillimit të karrierës

Në krye të organeve drejtuese të Fakultetit Ekonomik e cila është njësia kryesore që ofron Masterin Profesional në "Financë-Kontabilitet", qëndron Senati Akademik.

Senati Akademik është organi kolegjal më i lartë drejtues akademik i KU "LOGOS" dhe është përgjegjës për përmbushjen e misionit të tij.

Senati përbëhet nga 9 (nëntë) anëtarë. Senati kryesohet nga Rektori. Senati Akademik garanton autonominë e institucionit, lirinë akademike, si dhe të drejtat e studentëve. Senati harton strukturën e përgjithshme të institucionit, dhe e miraton pas konsultimit me administratorin e institucionit. Senati miraton programet e reja të studimit, të kërkimit shkencor, ndryshimet në këto programe dhe mbylljen e tyre, etj.

Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjal administrativ i KU "LOGOS". Bordi i Administrimit miratohet nga Presidenti i Fondacionit. Bordi përbëhet nga pesë anëtarë të punësuar me kohë të pjesshme. Një anëtar zgjidhet nga stafi akademik dhe ndihmës akademik prej Senatit, ndërsa katër anëtarët e tjerë zgjidhen nga sfera akademike. Anëtarët kanë mandat pesë vjeçar. Bordi i Administrimit garanton qëndrueshmërinë financiare të institucionit dhe përmbushjen e misionit, jep mendim për projekt rregulloren e KU "LOGOS" dhe miraton rregulloren financiare të tij, miraton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave, miraton rregullat e punësimit të administratorëve dhe personelit administrativ, miraton paraprakisht statutin përpara se të kalojë në Senat.

Rektorati është organi drejtues kolegjal që drejtohet nga Rektori dhe përbëhet përveç tij nga Administratori i institucionit dhe Dekanët (drejtuesit e njësive kryesore). Rektori harton planin strategjik të zhvillimit të institucionit, mbështetur në propozimet e drejtuesve të njësive bazë, njësive kryesore të fakultetit dhe të administratorëve. Rektorati analizon ecurinë e regjistrimit të studentëve, plotëson stafin akademik me kohë të plotë, analizon zhvillimin e procesit mësimor.

Dekanati është organi kolegjal drejtues që drejtohet nga Dekani dhe ka në përbërje të tij:

- Dekanin,
- Drejtuesit e njësisë bazë.

Dekanati koordinon të gjithë veprimtarinë e njësive bazë dhe kryesore. Dekanati harton planin strategjik të zhvillimit të njësisë kryesore. Disa nga funksionet kryesore janë: promovimi dhe motivimi i stafit akademik dhe shkencor, orienton njësitë për rishikim të programeve të studimit dhe në rast ndryshimi i propozon ato pranë Senatit, miraton orarin mësimor si dhe miraton raportin vjetor të veprimtarisë mësimore dhe shkencore.

Drejtuesit e njësisë bazë janë drejtuesit e departamenteve. Drejtuesi i njësisë bazë propozon hapje programesh studimi të reja apo ndryshime, përzgjedh mes kandidatësh stafin akademik efektiv dhe me kohë të pjesshëm dhe ia propozon dekanatit. Nxiti dhe motivon stafin akademik.

Asambleja e personelit akademik është organ akademik i njësive kryesore. Asambleja përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë i njësive kryesore. Në rast zgjedhesh, Asambleja e personelit akademik zgjedh anëtarët e senatit akademik, zgjedh rektorin dhe ja dërgon emrin për miratim bordit drejtues të Fondacionit Themelues.

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p>Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p>Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore "Doktor".</p>	<p>Fakulteti Ekonomik i KU "LOGOS" organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij. Secili nga organet drejtuese akademike ka një ndarje të qartë të detyrave dhe përgjegjësi. Po ashtu Fakulteti Ekonomik ka organizim si në njësi bazë ashtu edhe në njësi ndihmëse administrative duke ndarë qartë përgjegjësitë dhe duke mundësuar fokusimin e njësi bazë në organizimin e procesit mësimor.</p> <p>KU "LOGOS" përbëhet nga njësitë kryesore si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Fakulteti Ekonomik 2. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara <p>Secili Fakultet ka nga 3 (tre) njësi bazë, ku FE ka 3 departamente dhe Fakulteti i Shkencave të Aplikuara ka dy departamente dhe një Qëndër të Kërkimit shkencor, si më poshtë:</p> <p>Fakulteti Ekonomik</p> <ul style="list-style-type: none"> — Departamenti Financë Kontabilitet — Departamenti Menaxhim Biznes — Departamenti Menaxhim Turizëm. <p>Fakulteti i Shkencave të Aplikuara</p> <ul style="list-style-type: none"> — Departamenti Teknik i Lartë në laboratorë mjekësorë — Departamenti Informatikë e zbatuar — Qendra e Kërkimit dhe Zhvillimit <p>Fakulteti Ekonomik përbëhet nga tre departamente. Departamenti i Financës ofron Masterin Profesional në "Financë-Kontabilitet". Objektivat e Departamentit të Financë Kontabilitetit janë të mirëpërcaktuara në rregulloren e Departamentit të Financë-Kontabilitet.</p> <p>Departamenti siguron përafrimin me standardet evropiane të programeve të studimit dhe sigurimin e cilësisë së brendshme në mësimdhënie dhe kërkim shkencor. Ai nxit dhe koordinon aktivitete ndërdepartamentale, zgjedh stafin akademik, përzgjedh studentët, etj.</p> <p>Departamenti i Financë Kontabilitetit ka 7(shtatë) pedagogë efektivë, staf akademik të brendshëm, 3 (tre) prej tyre kanë tituj/grada shkencore.</p>
Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.	

Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.

Njësitë kryesore dhe njësitë bazë janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve.

Kështu, institucioni ka hartuar rregulloren e KU "LOGOS" dhe rregulloren e Fakultetit Ekonomik ku janë përcaktuar përgjegjësitë dhe objektivat që duhen përmbushur për realizimin e misionit të fakultetit.

Është hartuar rregullore e vecantë për njësinë bazë, Departamentin e Financë Kontabilitetit që ofron Masterin Profesional "Financë-Kontabilitet", duke i përcaktuar objektivat dhe funksionet në mënyrë të qartë dhe të ndërlidhura me ato të Fakultetit për mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor. Institucioni ka rregullore për Masterin Profesional në "Financë-Kontabilitet" ku përcaktohen objektivat e tij dhe ndarja e përgjegjësiave.

Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij. Në rregulloren e Departamentit të Financës (neni 4) shprehet qartë se është Departamenti që përzgjedh stafin akademik efektiv. Gjithashtu, në Manualin ku përcaktohet procedura e rekrutimit është departamenti ose fakulteti përkatës, i cili bën kërkesën për plotësimin e vendit vakant të punës duke specifikuar edhe kriteret e përcaktuara. Kjo shpallet në ëbsite të institucionit dhe median vizive dhe të shkruar.

Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar në rastin e praktikës së rekrutimit të një pedagogeje me kohë të plotë pranë Departamenti të Menaxhimit është ngritur komision me vendim Rektori dhe pjesë e këtij komisioni është Përgjegjësjja e departamentit të menaxhimit.

Gjithashtu edhe në vizitën në institucion na u konfirmua një gjë e tillë. Stafi ka një CV të pasur, përzgjedhja ka qenë cilësore.

Departamenti vlerëson ecurinë e çdo pedagogu nëpërmjet pyetësorëve që plotësohen nga studentët dhe analizohen me tej për vlerësim dhe praninë në auditor.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij. Fakulteti Ekonomik përbëhet nga tre departamente. Departamenti Financë Kontabilitet ofron Masterin Profesional në Financë-Kontabilitet.
2. Objektivat e Departamentit të Financë Kontabilitetit janë të mirëpërcaktuara në rregulloren e Departamentit të Financë Kontabilitetit.
3. Institucioni ka hartuar rregulloren e KU "LOGOS" dhe të Fakulteti Ekonomik, ku janë përcaktuar përgjegjësitë dhe objektivat që duhen përmbushur për realizimin e misionit të fakultetit.
4. Institucioni ka hartuar rregullore për njësinë bazë Departamentin Financë Kontabilitet duke përcaktuar objektivat dhe funksionet në mënyrë të qartë dhe të ndërlidhura me ato të Fakultetit për mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor. Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm

dhe në vlerësimin e tij.

Për sa është shpjeguar më sipër, konkludojmë që standardet në çështjen 2 “Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)” përmbushen plotësisht.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Fakulteti Ekonomik në total ka një personel akademik efektiv prej **20 (njëzet) pedagogësh**, nga të cilët **9 (nëntë) janë me tituj/grada.**

Departamenti Financë Kontabilitet ka **7(shtatë) pedagogë efektivë**, staf akademik të brendshëm. Përgjegjësja e departamentit ka titull akademik Profesor i Asociuar, 2 (dy) pedagogë kanë fituar gradën shkencore Doktor.

Numri i pedagogëve me kontratë të ftuar (të jashtëm) është 2 (dy), të dy me tituj/grada shkencore. Numri i personelit administrativ ndihmës në ofrimin e shërbimit nga ky Departament është 2 (dy).

Departamenti Menaxhim Biznesi ka **6 (gjashtë) pedagogë si staf akademik efektiv.** 3 (tre) prej tyre kanë grada shkencore. Nuk ka personel akademik të jashtëm.

Departamenti Menaxhim Turizëm ka **7 (shtatë) pedagogë si staf akademik efektiv** nga të cilët 4 (katër) janë me grada shkencore. Numri i pedagogëve me kontratë të ftuar (të jashtëm) është 2 (dy), me tituj/grada shkencore.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Struktura didaktike (seksionet) për departamentet ose programin e studimit

Departamenti i Financë Kontabilitetit nuk ka ndarje me seksione, por na u tha në vizitën në institucion se pedagogët ndahen sipas grup lëndëve, meqenëse janë ekspertë të fushave apo drejtimeve të caktuara të financës.

Përgjegjësinë organizative për programin e studimit “Master Profesional” në “Financë-Kontabilitet” e ka Këshilli Shkencor i programit të studimit “Master Profesional”, i cili bashkëpunon me Departamentin Financë Kontabilitet. Këshilli Shkencor i studimeve “Master” drejtohet nga koordinatori, i cili bashkëpunon me përgjegjësit e departamenteve të Fakultetit Ekonomik. Këshilli Shkencor i studimeve “Master” merret me organizimin e procesit mësimor, praktikave profesionale dhe mbrojtjen e diplomës.

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, (Plotëso Tabelat 1 dhe 2 në Aneks, të cilat mund të plotësohen edhe nga verifikimi i tabelave të paqyruara në RVB)

Tabelat 3.1 dhe 3.2 në Aneksin në fund të këtij materiali paraqesin informacionin lidhur me personelin akademik.

Për zhvillimin e programit Master Profesional në “Financë-Kontabilitet” janë angazhuar 6 pedagogë, 5 (pesë) janë pedagogë efektivë dhe 1 (një) është me kohë të pjesshme. Sipas tabelës së përditësuar të pedagogëve që japin mësim në këtë program, ata janë 4 (katër) pedagogë efektivë dhe 1 një i ftuar, duke përfshirë edhe Përgjegjësen e programit që është edhe Përgjegjëse e Departamentit e cila është edhe titullare e lëndës Taksim sipas syllabusave bashkëngjitur, numri i pedagogëve efektivë të angazhuar është 5 (pesë).

- Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinator/ët e programit të studimit (plotëso Tabelën 3)

Tabela 3.3 në Aneksin në fund të këtij materiali paraqet informacionin lidhur me këshillin shkencor.

Për organizimin e programit të studimit Master Profesional në "Financë-Kontabilitet" është ngritur Këshilli Shkencor i përbërë nga 3 anëtarë, të tre kanë gradë shkencore.

Njëri prej anëtarëve të Këshillit Shkencor është edhe Koordinator i Masterit Profesional në "Financë-Kontabilitet". Koordinatorin e njeh studentët me rregulloren, politikën e zhvillimit, kriteret e pranimit, planin dhe programet mësimore, rregullat e vlerësimit, praktikën, diplomimin, etj. Koordinatorin motivon studentët të marrin pjesë në aktivitete të KU "LOGOS" si dhe siguron ambientet e përshtatshme për zhvillimin e programit Master Profesional në "Financë-Kontabilitet". Këshilli Shkencor merret me organizimin e procesit mësimor, praktikave profesionale dhe mbrojtjen e diplomës.

- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (plotëso Tabelën 4)

Të gjithë pedagogët e angazhuar në programin e studimit Master Profesional në "Financë-Kontabilitet" janë me grada/tituj shkencorë, gjë që rrit cilësinë e mësimdhënies.

Tabela 3.4 në Aneksin në fund të këtij materiali paraqet të dhënat sipas kualifikimit

- Të dhënat sipas seksit

Gjinia	Femërore	Meshkullore
Personelit Akademik Efektiv	4	1
Personelit Akademik me Kontratë	-	1
Gjithsej	4	2

- Të dhëna sipas moshës së personelit

Stafi akademik, i cili është i angazhuar në Programin Master Profesional "Financë-Kontabilitet" është me moshë dominante nga 25-45 vjeç. Fakti që të gjithë janë me grada/tituj tregon motivimin e tyre për të ecur në karrierën akademike. Fakulteti po ofron mbështetje maksimale për ngritjen e tyre profesionale. Fakulteti organizon Konferencë vjetore dhe ka revistë 6 mujore, ku pedagogët mund të jenë pjesëmarrës pa pagesë. Gjithashtu Bordi i Administrimit ka përcaktuar fond të veçantë për çdo departament, fond i cili do të mbulojë kostot e publikimeve shkencore të pedagogëve.

Personeli sipas titujve/gradave	Numri i PAE me moshe				
	25-35	36-45	46-55	56-65	66-68
Profesorë					
As.Profesorë					1
Doktorë	2	2			
Pedagogë në proces Dr					
Asistentë me MA					
Asistentë pa MA					
Personeli sipas titujve/gradave	Numri i PAK me moshe				
	25-35	36-45	46-55	56-65	66-68
Profesorë					
As.Profesorë		1			
Doktorë					
Pedagogë në proces Dr					
Asistentë me MA					
Asistentë pa MA					

- Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Institucioni ka kontrata pune me çdo punëmarrës efektiv apo me kohë të pjesshme. Kontrata rregullon tërësinë e marrëdhënieve ndërmjet KU "LOGOS" dhe Punëmarrësve në lidhje me procesin e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe çdo element tjetër të veprimtarisë së punëmarrësve pranë institucionit. Në kontratë përcaktohet ngarkesa mësimore, të drejtat dhe detyrimet e punëmarrësve. Gjatë vizitës në institucion e konkretisht në Zyrën e Burimeve Njerëzore, u verifikuan kontratat e të gjithë stafit, ku ata i kishin të përcaktuar ngarkesën mësimore, të drejtat dhe detyrimet. Nga takimi me stafin na u komunikua që stafi nuk ishte i mbingarkuar madje nuk e arrinin ngarkesën, sepse në KU "LOGOS" dhe specifikisht në Masterin Profesional në "Financë-Kontabilitet" janë të regjistruar dhe vazhdojnë studimet një numër relativisht i ulët studentësh.

- Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Nga informacioni i paraqitur në RVB dhe nga vizita në institucion rezulton se programi Master Profesional në "Financë-Kontabilitet" ka staf ndihmës të motivuar dhe në dispozicion të këtij programi për rritje të cilësisë. Kështu, sekretaria mësimore dhe biblioteka ishte disponibël t'u shërbente studentëve me shërbimet e saj, edhe pse jo deri në orët e pasdites së vonë, edhe nëpërmjet marrëdhënieve ndërpersonale. Numri i vogël i studentëve bënte që stafi ndihmës të ishte i përkushtuar për t'i ndihmuar në çdo kohë. Zyra e marrëdhënieve me jashtë dhe Zyra e këshillimit të karrierës së bashku me Zyrën e marketingut, kjo e fundit e ngritur së fundmi, ishin në përpjekje të lidhjeve të marrëveshjeve me universitete të huaja për shkëmbim studentësh dhe stafi. Stafi i Zyrës së marrëdhënieve me jashtë dhe i Zyrës së këshillimit të karrierës është i përbërë nga pedagogë efektivë dhe si të tillë ata njohin tregun, kurrikulat dhe arritjet e studentëve duke qenë efektivë në punën e tyre.

Sipas RVB dhe tabelës në të, në këtë program angazhohen 6 pedagogë efektivë dhe një me kohë të pjesshme apo i ftuar, ku është edhe emri i Përgjegjës së departamentit të Menaxhim Biznesit, e cila rezulton e papërfshirë në këtë program. Ndërkohë që sipas tabelës së përditsuar duke përfshirë edhe Përgjegjësën e programit bëhen 5 (pesë) pedagogë efektivë dhe 1 (një) i ftuar. Por ky ndryshim nuk prek standardet, sepse në çdo rast pedagogët efektivë janë mbi 70% e stafit të angazhuar në program.

Sipas RVB përcaktohet se 75% e pedagogëve të angazhuar në program janë efektivë, saktësisht janë 83%, por ky ndryshim nuk çënon standardin.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
- Tabelë e përditsuar e personelit të angazhuar në PS.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;	Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe nëpërmjet programeve të lëndëve, përditësimit të tyre dhe ofrimit të eksperiencave më të mira, realizojnë objektivin më të rëndësishëm të Masterit Profesional - përgatitjen e profesionistëve të aftë në trajtimin e problematikave financiare dhe kontabël, që mund të shfaqen në biznese të ndryshme, në sistemin bankar apo në shoqëritë e sigurimeve. Personeli ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit ofron të gjitha

<p>Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>shërbimet e nevojshme të kërkuara nga studentët për ecurinë sa më të mirë mësimore dhe kërkimore, si dhe shërbime të tjera plotësuese për mbarëvajtjen e programit. Kështu Sekretaria mësimore, Zyra e këshillimit për karrierë të studentëve apo Biblioteka janë në shërbim të studentëve në oraret e përcaktuara dhe të shpallura.</p> <p>Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p> <p>Strategjia e institucionit për zhvillim synon rritjen e cilësisë së brendshme, cilësinë e mësimnxënies dhe mësimdhënies. Kjo realizohet me programet që ofrohen dhe syllabusat përkatës. Kjo realizohet me anë të rishikimit të vazhdueshëm të programeve jo vetëm nga përmbajtja, por edhe në metodikë që të jenë sa më bashkëkohore. Për këtë vjen në ndihmë edhe personeli ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit me asistimin e vet në përmirësim të metodikave, shërbimin e bibliotekës, etj.</p>
<p>Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve. Programi i lëndëve të Masterit Profesional në Financë-Kontabilitet, si nga përmbajtja edhe nga mënyra e organizimit, hartohet nga titullari i lëndës dhe miratohet nga Departamenti Financë Kontabilitet. Programet e lëndëve rishikohen dhe bëhen ndryshimet e nevojshme në fillim të çdo viti të ri akademik. Personeli akademik udhëheq temat e studentëve të Masterit Profesional, si dhe ndjek ecurinë e praktikave mësimore të tyre. Pedagogët janë pjesë e vendimmarrjes nëpërmjet Këshillit Shkencor të Masterit Profesional.</p> <p>Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Personeli akademik që jep mësim në programin e studimit Master Profesional në Financë Kontabilitet është me kohë të plotë dhe të pjesshme. Procedura e rekrutimit kryhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion e konkretisht në Zyrën e Burimeve Njerëzore, u verifikuan kontratat e të gjithë stafit, ku stafi njihej me ngarkesën mësimore, të drejtat dhe detyrimet. Gjithashtu nga kontratat e punës shihet se edhe ngarkesa mësimore përcaktohet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>
<p>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.</p>	

<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p>	<p>Sipas procedurës së parashikuar të rekrutimit, është Departamenti ose Fakulteti përkatës që bën kërkesën paraprake për plotësimin e vendit vakant të punës duke specifikuar edhe kriteret e përcaktuara. Kjo shpallet në ëbsite të institucionit, në median vizive dhe median e shkruar.</p> <p>Komisioni i ngritur me urdhër të rektorit vlerëson aplikimet. Komisioni vendos kriteret në bazë të rregullores së fakultetit, shqyrton dosjet e depozituara pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe përzgjedh kandidatin fitues. Kriteret e vendosura përfshijnë ekspertizën në fushën përkatëse, grada apo titulli përkatës, mesatarja dhe eksperiencia.</p> <p>Në programin Master Profesional në “Financë Kontabilitet” janë të angazhuar 5 (pesë) pedagogë efektive dhe 1 (një) pedagog me kontratë me kohë të pjesshme, raporti 5/1 ose rreth 83% e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit është me kohë të plotë.</p>
<p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Vlerësimi i personelit akademik bëhet prej studentëve nëpërmjet pyetësorëve. Rezultatet e pyetësorëve ju vihen në dispozicion pedagogëve në mënyrë që të shërbejnë për përmirësim të punës së tyre në procesin e mësimdhënies.</p> <p>Në sajë të dokumentacionit që u vu në dispozicion nga institucioni KU “LOGOS” rezulton se institucioni mban një bazë të dhënash të procedurave të rekrutimit të personelit në mënyrë të vazhdueshme. Në rregullore si dhe gjatë vizitës në institucion u përshkrua mënyra e njoftimit të vendeve vakante, por nuk është depozituar dokumentacion në lidhje me njoftimet për vende vakante, ndërkohë që ka dokumentacion të procedurës së rekrutimit.</p>
<p>Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.</p>	
<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p>	<p>Përgjegjësjë e programit të studimit “Master Profesional” në “Financë-Kontabilitet” ka titullin Profesor i Asociuar.</p> <p>Të gjithë titullarët e lëndëve në programin e studimeve Master Profesional në “Financë-Kontabilitet” kanë gradën shkencore “Doktor”, të fituar në universitete brenda ose jashtë vendit.</p> <p>Rektori, Dekani, Përgjegjësi i departamentit, Përgjegjësi i programit janë të gjithë me kohë të plotë.</p>

<p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p>	<p>Për shkak të numrit të vogël të studentëve Institucioni nuk ka në strukturë zv. Rektor dhe zv. Dekan.</p> <p>Në programin e studimit Master Profesional në “Financë-Kontabilitet” janë aktualisht vetëm 6 studentë. Numri i ulët i tyre bën që të ketë personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale. Kjo vlen edhe në nivel institucional.</p>
<p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	
<p>Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të dorëzuar dhe takimit me studentët, studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli.</p> <p>Sipas dokumentacionit të dorëzuar, pedagogët udhëheqës janë pedagogët e angazhuar me mësimdhënie në këtë program dhe siç u specifikua me lart ata janë të gjithë me grada shkencore/tituj akademikë.</p> <p>Nga dokumentacioni del se nga studentët e masterit profesional me përjashtim të një pedagogu që udhëheq 2 studentë, pedagogët e tjerë udhëheqin nga një student. Në takimet gjatë vizitës në institucion nga Përgjegjësja e Departamentit si dhe stafi u theksua se për shkak të numrit të ulët të përgjithshëm të studentëve, pedagogët nuk mbulonin më tepër se maksimumi i përcaktuar.</p>
<p>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</p>	
<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p>	<p>Pedagogët udhëheqës janë pedagogët e angazhuar me mësimdhënie në program dhe nisur nga CV e dorëzuara, kualifikimet dhe lëndët që ata japin janë në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p>


<p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Meqënëse të gjithë titullarët e lëndëve në programin e studimeve Master Profesional në “Financë-Kontabilitet” kanë gradën shkencore “Doktor”, të fituar në universitete brenda ose jashtë vendit, kjo është garanci e njohurive të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>
<p>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollorë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Institucioni është i angazhuar në mbarëvajtjen e mësimit. Sipas syllabuseve të lëndëve të programit Master Profesional nuk ka orë laborator. Gjatë vizitës në institucion na u tregua një laborator i ri. Shfrytëzimi i laboratorëve bëhet sipas përcaktimit të orëve mësimore dhe numri i ulët i studentëve që nënkupton numër të vogël grupesh seminari dhe leksioni duke bërë që stafi ndihmës mësimor-shkencor ta ketë të lehtë menaxhimin.</p> <p>Për përmbushjen e objektivave të programit të studimit Master Profesional në “Financë-Kontabilitet”, KU “LOGOS” angazhon një staf të kualifikuar duke synuar arritjen e objektivave të përcaktuara të programit. Gjithashtu në shërbim të këtij programi janë shumë aktivë stafet e zyrës së Marrëdhënieve me jashtë dhe Zyra e këshillimit të karrierës.</p>
<p>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p>Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programin e studimit Master Profesional në Financë-Kontabilitet vlerësohet me orë mësimore, siç edhe është paraqitur në dokumentacionin e dorëzuar.</p>
<p>Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p>	<p>Institucioni disponon bazën e të dhënave të stafit akademik të përfshirë në programin e studimit Master Profesional në “Financë-Kontabilitet”. Nga dokumentacioni i dorëzuar verifikohet se institucioni disponon CV, dokumentacionin ku bazohet CV dhe punimet shkencore të stafit akademik.</p> <p>Me vendim të Senatit Akademik çdo fillim viti përpilohet lista e plotë e pedagogëve të brendshëm dhe të jashtëm, që do të angazhohen në të dy</p>

<p>Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>semestrat. Kjo bazohet në dokumentacionin e dorëzuar nga KU "LOGOS" ku paraqitet vendimi i Senatit Akademik për vitin aktual.</p> <p>Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik në median vizive dhe të shkruar. Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, institucioni mban një bazë të dhënash të procedurave të rekrutimit të personelit në mënyrë të vazhdueshme. Kriteret e rekrutimit të personelit akademik janë të përcaktuara në Manualin mbi politikat dhe procedurat e Fakultetit Ekonomik, pranë KU "LOGOS", në zbatim të misionit dhe qëllimit.</p>
--	---

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Personeli akademik angazhohet në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre, nëpërmjet programeve të lëndëve, përditësimit të tyre dhe ofrimin e eksperiencave më të mira realizon objektivin e përgatitjes së specialistëve të aftë në trajtimin e problematikave financiare dhe kontabël.
2. Personeli ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit ofron të gjitha shërbimet e nevojshme të kërkuara nga studentët, duke u angazhuar në arritjen e objektivave të programeve të studimeve.
3. Personeli akademik merr pjesë aktive në përpilimin e programeve të lëndëve dhe në rishikimet apo ndryshimet e nevojshme. Procedura e rekrutimit të tyre kryhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
4. Personeli me kohë të plotë përbën 83% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit studimor. Vlerësimi i personelit akademik bëhet prej studentëve nëpërmjet pyetësorëve, rezultatet e pyetësorëve ju vihen në dispozicion pedagogëve. Institucioni mban një bazë të dhënash të procedurave të rekrutimit të personelit në mënyrë të vazhdueshme.
5. Pozicionet në organet drejtuese si Rektori, Dekani, Përgjegjësi i departamentit, Përgjegjësi i programit janë të gjithë me kohë të plotë. Të gjithë titullarët e lëndëve në programin e studimeve Master Profesional në "Financë-Kontabilitet" kanë gradën shkencore "Doktor", të fituar në universitete brenda ose jashtë vendit. Si të tillë kanë njohuri teorike dhe shkencore si dhe eksperiencë në punë hulumtuese kërkimore dhe kjo është e rëndësishme meqënëse po këta pedagojë janë udhëheqësit e tezës dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.
6. Me qëllim mbarëvajtjen e këtij programi është angazhuar maksimalisht edhe stafi ndihmës. Gjithashtu në shërbim të këtij programi janë shumë aktivë stafet e zyrës së Marrëdhënieve me jashtë dhe Zyra e këshillimit të karrierës.
7. Personeli akademik është i motivuar dhe jo i mbingarkuar, por sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi. Numri i vogël i studentëve bën që stafi akademik t'ju përkushtohet me tepër. Në çdo fillim viti përpilohet lista me përbërjen e pedagogëve të brendshëm dhe të jashtëm, që do të angazhohen në të dy semestrat. Institucioni disponon bazën e të dhënave të pedagogëve.

Për sa është shpjeguar më sipër, konkludojmë që standardet në çështjen 3 "Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studim" përmbushen plotësisht.




4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Gjatë vizitës në institucion, grupi i ekspertëve u njoh me ambientet e Fakultetit Ekonomik, i cili është njësisia kryesore që ofron këtë program. Mjediset për salla leksionesh dhe seminaresh ishin të mjaftueshme, duke pasur parasysh që Masteri Profesional në "Financë-Kontabilitet" zhvillohet mbase kur Bachelor ka përfunduar mësimin dhe Fakulteti Ekonomik ka vetëm këtë program masteri, mund të themi që për të zhvilluar këtë program Fakulteti Ekonomik i kishte të gjitha hapësirat ambientale për zhvillimin e tij.

Fakulteti praktikisht operonte me ambiente të ndara dhe të përcaktuara qartë për secilin departament, si për ambientet e mësimdhënies ashtu edhe të zyrave të stafit akademik.

Në ambientet e fakultetit ndodhet edhe një sallë promovuese apo konferencash, e pozicionuar në kati e dytë dhe që u shërben të dy fakulteteve të universitetit.

Programi Master Profesional në Financë-Kontabilitet nuk ka një laborator të dedikuar vetëm për programin, por mund të shfrytëzojë laboratorin e kompjuterave të programit Bachelor të Fakultetit Ekonomik.

Studentët e PS mund të shfrytëzojnë bibliotekën e Fakultetit Ekonomik pranë së cilës gjenden tekstet mësimore, periodikë dhe burime të tjera informacioni në formatin letër dhe elektronik, në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj kryesisht greqisht dhe anglisht. Ambienti i bibliotekës është i pajisur me kompjutera dhe shërben edhe si sallë interneti dhe studimi, ndërkohë që po punohej për zgjerimin e bibliotekës online.

Institucioni ka edhe zyrën e informacionit si dhe mjedis fotokopjimi, të cilat përdoren nga të dy fakultetet për shkak të numrit të vogël të studentëve. Nyjet hidrosanitare janë në çdo departament.

Fakulteti ka ndërtuar një palestër në ambientet e tij (pa pagesë) në mënyrë që të shërbejë si ambient argëtues dhe çlodhës për studentët

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit

- Salla për leksione
- Klasa për seminare
- Salla për aktivitete promovuese
- Salla për praktikë lëndore/ profesionale
- Laboratorë për lëndët
- Laboratorë informatike
- Salla interneti
- Salla për bibliotekë
- Mjedis për fotokopjime, librari etj
- Zyre informacioni për studentët
- Nyje hidrosanitare

Mjediset për stafin:

- Mjedise për Dekanin/ kancelarin
- Zyra për sekretarinë mësimore
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore
- Zyra për personelin akademik

Përsa i përket stafit drejtues, Dekanin dhe stafin akademik zyrat ishin të mjaftueshme. Dekani kishte zyrë të veçantë. Çdo pedagog kishte kushtet dhe mjetet e veta të punës të nevojshme për zhvillimin e detyrave dhe përgjegjësi.

Të gjitha Zyrat kishin ambiente të vecanta, kështu Zyra e marrëdhënieve me jashtë dhe e kërkimit shkencor, Zyra e këshillimit të karrierës, Zyra e Burimeve Njerëzore, Zyra e Financës dhe shërbimeve dhe Zyra e NJSBC. Gjithashtu ambiente zyre të posaçme kishin Alumni për takimet që zhvilloheshin dhe një zyrë e posaçme ishte për takime të pedagogëve me studentët që udhëhiqnin, duke pasur edhe oraret respektive të afishuara.

Sekretaria mësimore e Fakultetit Ekonomik është e organizuar me dy sekretarë ku njëri prej tyre mbulon vetëm Departamentin e Financës me programet që ofron.

Nga krahasimi i të dhënave nga RVB konstatojmë se nuk janë 2 laboratorë informatike por 1 laborator, por kjo nuk ndikon në programin e studimit Master Profesional në Financë-Kontabilitet pasi nuk ka në program orë në laboratorë. Gjithashtu ambienti çlodhës, kafe, fast food, etj. ishte krijuar si ambient, por është ende në proces vënia në funksionim.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>Shkolla e Lartë Private KU "LOGOS" ka vendndodhje të përhershme. Adresa është Rruga "Dritan Hoxha" pallatet "Komfort" (mbi NBG).</p> <p>Shkolla e Lartë Private KU "LOGOS" është licensuar me VKM Nr. 1055, datë 29.07.2009, që në atë moment ka qenë e dislokuar po në të njëjtën adresë, pra ka më tepër se 6 vjet që këto mjedise i janë vënë në dispozicion. Këto mjedise janë pronë e Kishës Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë dhe i janë dhënë me Kontratë Huapërdorjeje. Në materialet e dorëzuara nga institucioni është Kontrata e Huapërdorimit pa afat e lidhur në vitin 2015.</p> <p>Vetë Institucioni kryen veprimtarinë në dy godina të lidhura me korridore ku korridoret ishin shfrytëzuar si ambiente zyrash dhe mësimi. Nuk ka asnjë pengesë për mbarëvajtje të mësimi në programin Master Profesional në Financë-Kontabilitet, mësimi i të cilit zhvillohej në një godinë dhe çdo marrëdhënie me zyrat që mund të ishin në godinën tjetër realizohej nëpërmjet korridorit dhe/ose ashensorit.</p> <p>Ky kriter nuk aplikohet për këtë PS.</p>
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	

Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;

Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;

Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;

Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;

Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.

Në bibliotekën e Fakultetit Ekonomik ndodhen literaturat bashkëkohore që përdoren sot edhe në universitete të tjera, që ofrojnë studime në shkencat ekonomike. Megjithatë librat mund të ishin në numër më të madh dhe në gjuhë të tjera pasi dominon literatura në gjuhën greke. Meqënëse për pranimin e studentëve nuk ka ndonjë kriter të gjuhës greke, ato libra mund të ngelen pa u shfrytëzuar nga studentët.

Literatura që është disponibël në bibliotekë është bashkëkohore, duke i dhënë mundësi kujt do studentit që dëshiron të realizojë projektin e kërkimit shkencor aty.

Në bibliotekë ka botime periodike si botime periodike ashtu edhe në bibliotekë elektronike. Fakulteti Ekonomik është pjesë e bibliotekës elektronike të Universitetit të Pireut. Biblioteka ka bërë abonime edhe në librarinë online ee.uestia.com, gjë që na u tregua gjatë vizitës. Në planet e afërta ishte kompletimi i bibliotekës online.

Biblioteka është e pajisur me kompjutera që studentët mund t'i shfrytëzojnë. Biblioteka informonte studentët mbi eeb site me materiale mbi shkencat ekonomike ku studentët mund të hulumtonin. Gjatë vizitës në institucion u informuam se duke qenë se ky program studimi ka qenë objekt riorganizimi, kompletimi i literaturës së nevojshme për realizimin e procesit mësimor ka qenë në fokus të departamentit që e ofron. Si rregull janë Departamentet që bëjnë kërkesë në lidhje me nevojat në përditësim të literaturës dhe pas marrjes së miratimit paraprak të Bordit të Administrimit biblioteka kryen blerjet.

Biblioteka ka orare të përshtatshme për studentët, përfundim ky që e nxorëm pas takimit me studentët, të cilët ishin shumë të kënaqur nga shërbimi i bibliotekës.

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.

Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;

Institucioni disponon sasi të mjaftueshme të sallave të seminarit dhe leksioneve, zyra për stafin akademik dhe mbështetës të pajisur me pajisje elektronike, laboratorë dhe zyrë IT për të mbështetur sallën e laboratorëve, sallat e pedagogëve dhe çdo nevojë në infrastrukturën elektronike.

Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të

Mjediset mësimore kanë të gjitha pajisjet e nevojshme për mbështetje të mësimdhënies, si tabela, projektorë, kompjutera.

përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;

Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;

Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.

Laboratori ka aparaturat e nevojshme për plotësimin e çdo nevoje që mund të kenë studentët gjatë zhvillimit të programit mësimor.

Ky program nuk ka praktika laboratorike. Megjithatë laboratori është ngritur pranë Fakultetit Ekonomik. Praktika profesionale zhvillohet pranë institucioneve dhe bizneseve të ndryshme.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Shkolla e Lartë Private KU "LOGOS" kryen aktivitetin në të njëjtën adresë, që prej momentit të licensimit.
2. Programi i Masterit Profesional në Master Profesional zhvillohet me literaturë bashkëkohore të përdorur gjerësisht në universitete shqiptare dhe të huaja
3. Në bibliotekë ka botime periodike dhe siguron lidhje me biblioteka-librari elektronike. Biblioteka ka orare të përshtatshme për studentët
4. Institucioni disponon sasi të mjaftueshme të sallave të seminarit dhe leksioneve, zyra për stafin akademik dh mbështetës të pajisur me pajisje elektronike.

Për sa është shpjeguar më sipër konkludojmë që standardet në çështjen 4 "Infrastruktura në funksion të programit të studimit, etj." përmbushen plotësisht.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Institucioni KU "LOGOS" ka hartuar planin financiar për programin e studimit Master Profesional në "Financë-Kontabilitet". Gjatë vizitës, si dhe në dokumentacionin e dorëzuar, është theksuar karakteri jofitimprurës i "KU "LOGOS"". Kjo gjë mbështetet nga të dhënat financiare.

Në Planin financiar të Masterit Profesional në "Financë-Kontabilitet" janë paraqitur të ardhurat dhe shpenzimet për vitin 2017-2018. Shpenzimet janë parashikuar të jenë 3.700.000 lekë dhe janë planifikuar të përballohen pjesërisht me tarifat e studentëve dhe pjesërisht me financime nga themeluesi i Fondacionit "LOGOS" Prof.Dr. Anastasios Yannoulatos.

Nuk ka të ardhura nga grante, shërbime trajnuese, konsulenca, subvencione apo aktivitete tregtare. KU "LOGOS" ka përshtatur ambientin për ofrimin e një shërbimi tregtar bar kafe në ambientet e saj por ende nuk ishte përcaktuar mënyra e menaxhimit të tij. KU "LOGOS" ka ndërtuar një ambient sportiv (palestër) në ambientet e veta, por hyrja në këtë ambjent sportiv ishte pa pagesë.

Përsa i përket shpenzimeve për studentët, institucioni ofron ambientiv sportiv që për studentët është falas, por për institucionin ka shpenzime mirëmbajtje dhe për instruktorin. Nga informacioni i marrë gjatë vizitës të gjitha shpenzimet e tjera të KU "LOGOS" mbulohen nga donacionet e Fondacionit "LOGOS".

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):

- Grantet për kërkim
- Konsulencat, shërbimet
- Tarifat për dhe gjatë shkollimit
- Sponsorizimet
- Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)
- Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione etj
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)

Tabela 5.1 në Aneksin në fund të këtij materiali paraqet të ardhurat dhe shpenzimet (në përqindje) për tre vitet më të fundit akademike (2015-2017).

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Tarifa vjetore e një studenti është e njëjtë për Fakultetin Ekonomik si në nivelin Bachelor edhe në Masterin Profesional me një vlerë 150.000 lekë.

Të ardhurat në total janë parashikuar në 3.700.000 lekë të parashikuar nga 15 studentë, respektivisht plani ka qenë: 1. Tarifat e studentëve 2.250.000 lekë , dhe 2. Donacion 1.450.000 lekë.

Por programi i studimit ka vetëm 6 studentë nga të cilët një është me bursë, pra të ardhurat nga studentët janë: 150.000 lekë *5 = 750.000 lekë dhe pjesa tjetër është mbuluar me donacion. Nga vizita u konfirmua se së fundi Bordi i Administrimit ka akorduar fond për çdo departament për mbulim të aktiviteteve shkencore të pedagogëve dhe nevoja departamentale. Nëse i qëndrojmë shpenzimeve të deklaruara 3.700.000 lekë, atëherë të ardhurat nga tarifat e studentëve aktualë mbulojnë rreth 20% të shpenzimeve.

Nisur edhe nga karakteri jofitimprurës, KU "LOGOS" ofron Bursa studimi për kategorinë e studentëve në vështirësi ekonomike dhe studentët me rezultate të larta. Kështu trajtohen me Bursa 22 studentë që ndjekin studimet prane KU "LOGOS". Fondi i akorduar është 2.500.000 lekë ku 1.400.000 lekë jepen bursa për studentë me probleme ekonomike, ndërsa 1.100.000 lekë ju jepen bursa studentëve me rezultate të larta. Nga studentët e Masterit Profesional në Financë-Kontabilitet përfiton bursë një student si student në vështirësi ekonomike.

KU "LOGOS" mbulon të gjitha kostot e organizmit të Konferencës Shkencore Ndërkombëtare dhe Konferencës studentore si dhe botimit të Revistës "LOGOS" (si për stafin edhe për studentët e KU "LOGOS" pjesëmarrja dhe botimet janë falas). Aktualisht Bordi i Administrimit ka miratuar fond të vecantë për Qendrën e Kërkimit Shkencor ku është e përcaktuar edhe shumën e konferencave prej 450.000 lekë si dhe ka akorduar buxhet për Zyrën e karrierës në shumën 20.000 lekë për aktivitete studentore.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
- Pasqyrat financiare me raportin e audituesit të jashtëm për vitin 2017

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	

Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;

Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;

Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.

Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.

Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.

Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.

KU "LOGOS" është pjesë e Fondacionit "LOGOS" që harton dhe publikon pasqyra financiare vjetore mbi aktivitetin e zhvilluar në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (Standardi për OJF) dhe në pajtim me ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare. Çdo vit këto pasqyra i nënshtrohen vlerësimit të ekspertit kontabël të autorizuar për vërtetësinë dhe sinqeritetin e informacionit të paraqitur në to. Informacioni i paraqitur në pasqyrat financiare përsa u takon shpenzimeve i referohet të gjithë institucionit si një njësi e vetme.

Në pasqyrat financiare të audituara evidentohen qartë donacionet e përfituara nga fondacioni "LOGOS", kryesisht për kompensim shpenzimesh. Aktualisht KU "LOGOS" nuk ka të ardhura nga grante të huaja apo kontrata shërbimesh.

Në raportin e audituesit të jashtëm për vitin 2017 të ardhurat janë të analizuar sipas ciklit të studimeve dhe aktiviteteve të tjera ndërsa shpenzimet paraqiten në nivel institucioni dhe jo sipas programeve apo ciklit të studimeve.

Pasqyra e performancës (e bazuar në klasifikimin e shpenzimeve sipas funksionit) evidenton të gjitha të ardhurat e realizuara sipas ciklit të studimeve dhe aktiviteteve të tjera dhe të gjitha shpenzimet e kryera për periudhën ushtrimore në nivel institucioni. Për programin Master Profesional në "Financë-Kontabilitet", ky është viti i parë i funksionimit dhe aktualisht KU "LOGOS" ka hartuar një Plan Financiar ku pasqyrohen të dhënat kryesore financiare të parashikuara për vitin akademik 2017-2018.

Gjatë vizitës dhe bisedave nuk rezultoi që të përgatitej ndonjë raport financiar tjetër mbi baza programi apo cikli studimesh.

Shkolla e Lartë Private KU "LOGOS" është pjesë e Fondacionit LOGOS. Sipas dokumentacionit të dorëzuar, pasqyrave financiare, raportit të audituesit të jashtëm rezulton se KU "LOGOS" ka qëndrueshmëri financiare.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Institucioni KU "LOGOS" si pjesë e Fondacionit "LOGOS" i nënshtrohet auditimit të jashtëm të përvitshëm.
2. Në pasqyrat financiare të publikuara të fondacionit "LOGOS" paraqitet situata financiare

dhe performanca sipas zërave përkatës në nivel institucioni.

3. Zyra e financës e KU "LOGOS" ka hartuar planin financiar të të ardhurave dhe shpenzimeve të ndara në shpenzime korrente, shpenzime kapitalesh, shpenzime investimesh dhe të tjera të parashikuar për këtë PS.
4. Sipas dokumentacionit të dorëzuar, pasqyrave financiare, dhe raportit të audituesit të jashtëm rezulton se KU "LOGOS" ka qëndrueshmëri financiare.

Për sa është shpjeguar më sipër, konkludojmë që standardet në çështjen 5 "Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare" përmbushen plotësisht.

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Krijimi i NJBSC është bërë me Vendim nr.1213 datë 16.11.2015 (bazuar nga dokumentacionet e dorëzuara), pasi është propozuar nga dekani i Fakultetit Ekonomik. Qëllimi i krijimit të kësaj njësie ishte zbatimi i ligjit të Arsimit të lartë nr.80/2015, "PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", neni 103 për "Sigurimin e brendshëm të cilësisë". Në këtë vendim janë miratuar edhe anëtarët e stafit.

Në Vendimin nr.7 datë 13.02.2017 të Senatit akademik të Shlp KU "LOGOS" është miratuar krijimi i grupit të punës për sigurimin e cilësisë së brendshme dhe ngritjen e NJSBC për secilin nga dy fakultetet.

Me Vendim Senati nr.43 datë 08.02.2018 është miratuar ndryshimi i grupeve të punës si në nivel institucional edhe në nivel fakultetesh.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:

- Sa anketime kanë bërë me studentët
- Sa studentë janë anketuar
- Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
- Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm
- Etj

Programi i studimit Master Profesional në "Financë-Kontabilitet" është i hapur rishtas dhe si rrjedhojë janë anketuar studentët që janë aktualisht, të cilët janë vetëm 6. Pyetësorët janë përpunuar dhe rezultati ka qenë pozitiv. Studentët vlerësojnë pozitivisht çdo aspekt të mësimdhënies që nga metodat e shpjegimit ashtu edhe të vlerësimit, kjo gjë na u theksua nga studentët në takimin në institucion ku ishin prezent të 6-të.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

NJBSC realizon anketimin e studentëve në lidhje me vlerësimin e pedagogëve prej tyre, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të procesit mësimor. Kështu NJBSC shpërndan pyetësorët, i mbledh dhe i përpunon, përpilon tabelën përfundimtare për vlerësimin e çdo pedagogu dhe i vë në dijeni.

NJBSC monitoron procesin e provimeve, grafikun e provimeve ku merret edhe mendimi i studentëve. NJBSC kontrollon sigurimin e respektimit të rregullores së përcaktuar në lidhje me nivelin e frekuentimit të mësimit nga ana e studentëve. NJBSC verifikon korrektesën e datës së dorëzimit të rezultateve të provimit dhe mban në mbikëqyrje nëpërmjet rezultateve ecurinë e studentëve.

NJBSC kontrollon plotësimin e regjistrave nga ana e pedagogëve në lidhje me temat e zhvilluara, datat dhe mungesat.

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti KU "LOGOS" në bazë të Statutit, rregullores së institucionit, departamenteve dhe programit të studimit ka përgjegjësi të ndara qartë nga institucioni si një i tërë deri në nivel departamenti.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre
Ky program studimi është një program i ri, që rrjedh nga riorganizimi i programit të ciklite të dyte, Master Profesional në Finance Kontabilitet, i cili është ofruar me kohezgjatje 1.5 vite akademike dhe 90 ECTS. Sipas urdhrin të MASR nr. 428, datë 22.09.2017, tashme ky program është pershtatur me kërkesat e ligjit të arsimit të lartë 80/2015, duke u ofruar me kohezgjatje 1 vit akademik dhe 60 ECTS.
Programi i origjines është licencuar me UMASH nr. 335, datë 16.08.2013, duke u mbështetur në vendimin e KA nr. 524, datë 18.07.2013. Ky program ka kaluar procesin e pare të akreditimit në fillim duke marrë një akreditim me kusht me urdhrin e MAS nr. 342, datë 17.09.2015, udher i mbështetur në rekomandimin e bere në vendimin e KA nr. 69, datë 27.07.2015. Keto kushte u plotesuan nga institucioni dhe janë hequr me urdher nr. 606, datë 22.12.2016, mbështetur në vendimin e KA nr. 211, datë 18.11.2016. "


Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike
KU "LOGOS" ka politika dhe procedura të qarta për rritjen e cilësisë, vecanërisht në rastin e programit të studimit Master Profesional në "Financë-Kontabilitet", i cili është program i ri. Vetëvlerësime periodike përveç semestrit të parë nuk ka, por është në objektivat e institucionit t'i kryejë me qëllim rritjeje të cilësisë, siç janë analiza e sondazheve me studentët, asistim në auditorë, kontroll i ecurisë së arritjeve shkencore apo publikimet shkencore, etj.

Në RVB shkruhet se NJBSC është ngritur me Vendim Senati nr.43 datë 08.02.2018, ndërkohë që nga dokumentacionet e dorëzuara rezulton se NJBSC është krijuar në vitin 2015. Tabelat 6.1 dhe 6.2 në Aneksin në fund të këtij materiali paraqesin të dhënat për përbërjen e NJBSC.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	



Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;

Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;

Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.

Të tërthorta:

- a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;
- b. Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit;
- c. Pyetje konceptuale;
- d. Intervista;
- e. Etj.

Të drejtpërdrejta:

- a. Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj);
- b. Dëgjime në auditor;
- c. Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;
- d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;
- e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, projektet, provimet, etj.);
- f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;
- g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;
- h. Etj.

Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese si pyetësorë drejtuar studentëve, kontroll të regjistrave, analiza e rezultateve. Megjithatë kjo është kryer vetëm për semestrin e parë për këtë Master Profesional pasi ky program është i hapur këtë vit akademik.

Informacioni i mbledhur përpunohet dhe analizohet nga NJBSC për arsye të vetvlerësimit dhe ju komunikohet stafit përgjegjës me qëllim përmirësimin e cilësisë së brendshme.

Rezultatet shpallen publikisht në një takim të grupit me stafin ku vihen në dijeni për ecurinë e gjithësecilit, kjo e thënë si nga stafi ashtu edhe nga NJBSC gjatë vizitës në institucion.

Institucioni përdor metoda të tërthorta si:

- Sondazhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike kur programi ishte 1.5 vite;
- Sondazhet kryhen për çdo cikël të studimeve;
- Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit.

Institucioni përdor metoda të drejtpërdrejta si:

- Dëgjime në auditor nga grupi i vlerësimit të brendshëm;
- Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë, nxirret edhe mesatare studenti dhe grupi për të kuptuar më saktë nivelin e tyre;
- Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module. Gjatë praktikave profesionale studentët mbikëqyren dhe vlerësohen;
- Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit.

Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.

Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;

Institucioni publikon fletëpalosje, si dhe publikon informacione mbi fakultetin, përfshirë edhe vlerësimi i brendshëm në faqen zyrtare të internetit.

Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.

Institucioni publikon rregullisht në faqen e vet të internetit informacione për vlerësimin e brendshëm dhe më gjerë.

Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.

Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecures së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;

Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecures së programeve të studimeve, me rezultate konkrete, bazuar në dokumentacionin e dorëzuar. Ky program është vlerësuar vetëm për një semestër.

Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.

Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë. Këto politika i gjejmë në strategjinë e dorëzuar dhe planin financiar. Nga takimet na u confirmua që po hartohet strategjia e institucionit për 2018-2022, ku përfshihen edhe politikat e përmirësimit të programeve të studimit.

Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.

Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;

Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional me Urdhër nr.282 të datës 04.07.2012 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

Institucioni ka kryer procesin e akreditimit periodik me Vendim të Bordit të Akreditimit nr. 95, date 20.10.2017.

Masteri Profesional në "Financë-Kontabilitet" është akredituar me kusht me Urdhër nr. 342, datë 17.09.2015, në bazë të Vendimit nr. 69, datë 27.07.2015 të Këshillit të Akreditimit. MP ne Finance Kontabilitet eshte licencuar dhe ofruar ne kete kohe me 90 ECTS.

Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;

Kushtet e vendosura u plotësuan dhe I jane hequr kushtet me urdher nr. 606, date 22.12.2016, mbeshtetur ne vendimin e KA nr. 211, date 18.11.2016

Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e

Programi eshte riorganizuar me Urdher te MASR nr.428, dt. 22.09.2017 dhe aktualisht ofrohet me 60 ECTS dhe viti akademik 2017-2018 eshte viti I pare qe ky program ofrohet ne kete forme.

Për sigurimin e cilësisë, institucioni përdor

cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;

Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;

Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;

Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.

shumë instrumente që nga asistenca në auditorët e mësimit, ndjek kualifikimin e pedagogëve dhe i motivon ata përmes konferencave dhe revistave shkencore. Institucioni kryen sondazhe me studentët për mësimdhënien, metodologjinë, etj.

Institucioni ndjek një politikë dhe procedura të mirëpërcaktuara në lidhje me sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve. Kështu, institucioni përveç ngritjes së NJBSC që ka detyra dhe procedura të përcaktuara, përzgjedh stafin në bazë të kualifikimeve dhe nevojave të institucionit dhe mban kontakte me partnerë të tregut të punës për përmirësim të vijueshëm të programeve.

Institucioni përdor mekanizma formalë siç është jo vetëm ngritja e NJBSC, por edhe rifreskimi i stafit me studentë në vitin e fundit në mënyrë që edhe vendimmarrja dhe analiza të jetë e përbashkët staf-pedagogë dhe që programet e studimit të arrijnë objektivat.

Nga vizita në institucion si edhe nga dokumentacionet që institucioni ka dorëzuar spikat komunikimi i vazhdueshëm me stafin, studentët aktualë dhe të diplomuar për ndërgjegjësimin e rritjes së cilësisë së programit të studimit. Nga dokumentacioni i dorëzuar janë realizuar për këtë qëllim disa takime me studentë aktualë dhe të diplomuar. Ndërsa komunikimi me stafin ishte i vazhdueshëm dhe stafi dukej shumë i motivuar në këtë drejtim.

Aktualisht institucioni operon me strategjinë e 2012-2017 dhe është duke punuar për strategjinë 2018-2022. Pjesë e strategjisë janë politikat e institutit në lidhje me kërkimin shkencor, mësimdhënien, menaxhimin e bibliotekës, etj. Dhe këto prezantohen vazhdimisht në takime me studentë apo bashkëpunëtorë të institucioneve si dhe gjimnazistë që janë studentë potencialë të ardhshëm. Këto janë të publikuara edhe në faqen e internetit të institucionit.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese si pyetësorë drejtuar studentëve, kontroll të regjistrave, analiza e rezultateve. Për sigurimin e cilësisë institucioni përdor shumë instrumente që nga asistenca në auditorët e mësimit, ndjek kualifikimin e pedagogëve dhe i motivon ata përmes konferencave dhe revistave shkencore. Institucioni kryen sondazhe me studentët për mësimdhënien, metodologjinë, etj.

2. Informacioni i mbledhur përpunohet dhe analizohet nga NJBSC për arsye të vetvlerësimit dhe ju komunikohet stafit përgjegjës me qëllim përmirësimin e cilësisë së brendshme.
3. Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve, me rezultate konkrete, bazuar në dokumentacionin e dorëzuar. Ky program është vlerësuar vetëm për një semestër.
4. Institucioni përveç ngritjes së NJBSC që ka detyra dhe procedura të përcaktuara, përzgjedh stafin në bazë të kualifikimeve dhe nevojave të institucionit dhe mban kontakte me partnerë të tregut të punës për përmirësim të vazhdueshëm të programeve.

Për sa është shpjeguar më sipër, konkludojmë që standardet në çështjen 6 "Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë" përmbushen plotësisht.

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore



Programi i studimit Master Profesional në "Financë-Kontabilitet", i ofruar nga Kolegji Universitar "LOGOS", synon ndërthurjen e njohurive të thelluara teorike dhe praktike nga fusha e financës dhe kontabilitetit me qëllim përgatitjen e profesionistëve të aftë për të menaxhuar dhe analizuar në mënyrë eficiente sfidat dhe mundësitë që hasin biznese të mëdha e të vogla në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Në funksion të këtij objekti kurrikula e këtij programi studimi, të organizuar me kohë të plotë nga e hëna deri të premten, përfshin lëndë që mundësojnë thellimin e dijeve në fushën e financës dhe kontabilitetit.

Plani mësimor për këtë program studimi siguron një shpërndarje të balancuar të ngarkesës mësimore mes orëve të parashikuara në auditor dhe punës së pavaruar të studentit. Për përfitimin e diplomës në programin e studimit Master Profesional në "Financë-Kontabilitet" studentët duhet të realizojnë 60 kredite, të cilat mund të përmbushen gjatë një viti akademik ose 2 semestrave. Gjatë semestrit të dytë studentët kryejnë edhe praktikën profesionale, si dhe realizojnë punimin dhe mbrojtjen e mikrotezës. Studentët në fillim të vitit akademik informohen mbi lëndët që do të zhvillojnë nëpërmjet syllabuseve të përgatitura sipas standardeve të Kolegjit Universitar "LOGOS".

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi Viti akademik 2017-2018 është viti i fillimit për programin e studimit Master Profesional në "Financë-Kontabilitet" me 60 kredite në përputhje me kërkesat e ligjit 80/2015 dhe Urdhërit të Ministrit Nr 428 datë 22/09/2017 për riorganizimin e programit të studimeve të ciklit të dytë Master Profesional.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor

Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

Plani mësimor I këtij program studimi me 60 kredite ECTS organizohet në dy semestra brenda një viti akademik dhe parashikon zhvillimin e 8 lëndë/module me një shpërndarje të krediteve në përputhje me ngarkesën për format e studimit dhe aktet nënligjore në fuqi. Konkretisht plani mësimor përfshin 2 lëndë të kategorisë veprimtari në disiplina të formimit të përgjithshëm me nga 6 kredite secila, 4 lëndë të kategorisë veprimtari në disiplina të formimit karakterizues nga të cilat 3 lëndë vlerësohen me 6 kredite dhe një me 5 kredite, një lëndë në kategorinë e veprimtarisë në disiplina të formimit integruar me 5 kredite, një lëndë në kategorinë e disiplinës me zgjedhje me 5 kredite, praktikën profesionale me 5 kredite dhe temën e diplomës me 10 kredite. Tabelat 7.1 dhe 7.2 në Aneksin në fund të këtij materiali paraqesin planin mësimor sipas semestrave, si dhe ndarjen e ECTS-ve sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë.

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

- Për leksionet 10/12 orë në auditor dhe 15/13 orë punë e pavarur e studentit.
- Për Seminaret 10/12 orë në auditor dhe 15/13 orë punë e pavarur e studentit.
- Për Praktikën Profesionale 20 orë në auditor dhe 5 orë punë e pavarur e studentit.
- Provimi përfundimtar 5 orë në auditor dhe 20 orë punë e pavarur e studentit.

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara (Plotësoni Tabelën 6, Aneksi 6)

Viti akademik 2017-2018 është viti i fillimit për programin e studimit Master Profesional në "Financë-Kontabilitet" me 60 kredite.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Plotëso Tabelën 7, Aneksi 7)

Tabela 7.3 në Aneksin në fund të këtij materiali paraqet planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

1. Emërtimi i lëndës/modulit
2. Viti/semestri kur zhvillohet lënda
3. Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
4. Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
5. Njohuritë paraprake që
6. duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës
7. Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
8. Temat që do të trajtojnë lënda në formimin teorik dhe praktik
9. Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
10. Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
11. Format e vlerësimit të studentëve
12. Detyrimet e studentit për lëndën
13. Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Programi i studimit Master Profesional në "Financë-Kontabilitet" me 60 kredite është i organizuar me 8 lëndë/module nga të cilat 7 janë të detyrueshme dhe 1 është me zgjedhje, të gjitha të vlerësuara sipas sistemit ECTS. Për të përvetsuar si duhet lëndët e përfshira në këtë program studimi, mjafton që studentët të kenë nivelin e njohurive të sistemit bachelor të një fakulteti ekonomie të akredituar ose ekuivalente. Përgatitja e syllabuseve për secilën lëndë realizohet nga titullari i lëndës, në përputhje me formatin tip të miratuar dhe Rregulloren e Përgjithshme të KU "LOGOS", si dhe miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit dhe Dekani i Fakultetit të Ekonomisë. Secili pedagog kujdeset për rishikimin dhe përditsimin e syllabusit për lëndën që mbulon me qëllim që studentët të marrin informacionin e nevojshëm për t'ju mundësuar një formin teoriko-profesional në përputhje me nevojat e tregut të punës. Ngarkesa e orëve të parashikuar në auditor dhe jashtë auditorit është e balancuar dhe format dhe metodat e mësimdhënies janë në përputhje me praktikatat bashkëkohore përkatëse. Me qëllim angazhimit dhe vlerësimit e vazhdueshëm të studentëve, PS përdor një sistem të përzier vlerësimi për studentët për secilën lëndë ku 10% të vlerësimit e zë pjesëmarrja dhe aktivizimi në auditor, 30% testet e ndërmjetme, 10% detyrat e kursit dhe 50% provimi final. Literatura e parashikuar në syllabuse konsiderohet si literaturë bazë dhe nuk ka ndarje mes literaturës së detyrueshme dhe asaj ndihmëse.

Gjykojmë që në funksion të rritjes së interesit për këtë program studimi dhe në përputhje me objektivat e tij specifike lidhur me tregun e punës, do të ishte me vlerë shtimi i lëndëve me zgjedhje në modulën përkatës si psh lënda "Auditim", "Sigurime", "Kontabilitet Drejtimi" etj.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
 - Stafi akademik i angazhuar në procesin mësimor për realizimin e programit të studimit "Master Profesional" në "Financë-Kontabilitet" për vitin akademik 2017-2018.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi 1.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në Financë-Kontabilitet" është çelur bazuar në urdhërin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, nr. 428, dt. 22/09/2017. Programi i studimit është i organizuar në module dhe lëndë mësimore, të cilat vlerësohen me kredite, në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Në programin e studimit Master Profesional në Financë-Kontabilitet respektohet shpërndarja e krediteve në një vit. Programi zgjat një vit akademik dhe ngarkesa është 60 kredite.</p>
Standardi 1.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave", "Master i arteve të bukura" apo "Master Profesional" i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare "Bachelor" me njohuri të thelluara, teorike dhe</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe takimet e zhvilluara GVJ vlerëson se programi i studimit Master Profesional në Financë-Kontabilitet u ofron studentëve që zotërojnë diplomën bachelor njohuri të thelluara teorike dhe praktike. Trajnimi</p>

praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;

Kriteri 3 Programet e studimeve "Master i Shkencave" ose "Master i arteve të bukura" dhe "Master Profesional" synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;

Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;

Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;

Kriteri 6 Programet e studimeve "Master i Shkencave" ose "Master i arteve të bukura" dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;

Kriteri 7 Programet e studimeve "Master Profesional" kanë objektiva të qartë profesionalë, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

profesional i studentëve të programit ofrohet si gjatë zhvillimit të moduleve gjatë zhvillimit të pjesës teorike të masterit, ashtu edhe gjatë zhvillimit të praktikës mësimore në semestrin e dytë të programit të studimit.

Programi i studimit Master Profesional në Financë-Kontabilitet, bazohet në kurrikulën e nivelit bachelor në Financë-Kontabilitet dhe synon zgjerimin dhe thellimin e njohurive të marra në atë nivel.

Kriteri 4 nuk zbatohet për këtë program studimi.

Programi i studimit Master Profesional në Financë-Kontabilitet synon të pajisë studentët me kompetenca të përgjithshme, kompetenca specifike dhe kompetenca të transferueshme, të cilat janë të përcaktuara në misionin dhe objektivat e këtij programi studimi.

Kriteri 6 nuk zbatohet për këtë program studimi.

Programi i studimit ka objektiva të qartë profesionalë, të arritshëm dhe në përputhje me nevojat e tregut të punës.

Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.

Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;

Kriteri 2 Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.

GVJ konstaton se objektivat e programit të studimit përputhen me nivelin e studimeve të ciklit të dytë. Kështu në aspektin e njohurive programi ofron njohuri të specializuara, të cilat shërbejnë si bazë për një të menduar, kërkim origjinal si edhe analizë kritike. Në aspektin e aftësive programi zhvillon aftësi për ekspertizë dhe në aspektin e kompetencave programi ofron kompetenca të përgjithshme, specifike dhe të transferueshme, duke mundësuar kështu qëndrim të pavarur dhe një performancë të kënaqshme të studentëve.

Metodat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrolleve të vazhdueshme (detyra kursi, pjesëmarrje aktive në auditor, teste kontrolli, provim përfundimtar) dëshmojnë ecurinë e studentëve gjatë programit të studimit.

Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.

Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disa vjeçare dhe praktikën e mira të vendeve evropiane;

Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomën që jepet në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;

Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.

Programi i studimit Master Profesional në Financë-Kontabilitet është hartuar bazuar në përvojën më të mirë të universiteteve evropiane dhe të vendit. Për këtë qëllim KU "LOGOS" ka shfrytëzuar dhe marrëveshjet e bashkëpunimit të lidhura me universitete të tjera.

Programi i studimit paraqitet konkurrues në nivel ndërkombëtar për nga elementët që përmban si: objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit të aplikantëve, metodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diploma që jep, etj.

Programi i studimit Master Profesional në Financë-Kontabilitet është hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë.

Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.

Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;

Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;

Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;

Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.

Programi i studimit parashikon kryerjen e një praktike profesionale e cila vlerësohet me 5 kredite (ECTS).

Programi i studimit Master Profesional në Financë-Kontabilitet është hartuar në përputhje me profilin e KU "LOGOS" dhe me strategjinë e zhvillimit të tij.

Nga takimet dhe dokumentacioni (dosjet personale të pedagogëve, analiza periodike e punës kërkimore-shkencore etj) rezulton që personeli akademik angazhohet në punën kërkimore-shkencore jo vetëm në funksion të kualifikimit individual të tyre por edhe në funksion të sjelljes së një vlere të shtuar në mësimdhënie dhe në realizimin e synimit të programit të studimit, në përditësim me zhvillimet në fushën e studimit të programit.

Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit të marë në shqyrtim përkon me synimet për arritjen e qëllimit të tij.

Standardi I.7 - Programet e studimeve "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.

Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;

Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.

Programi i studimit "Master Profesional" në "Financë-Kontabilitet" ofrohet në përputhje me nevojat e tregut të punës.

Ky program studimi synon të plotësojë nevojat në rritje për profesionistë cilësorë të fushës së financës dhe kontabilitetit.

Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.

Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;

Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:

- a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar;
- b. kërkesat e punëdhënësve;

Bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe takimet e zhvilluara GVJ vlerëson se programi i studimit merr parasysh nevojat e tregut të punës dhe objektivat strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar.

KU "LOGOS" vlerëson nevojat e tregut të punës përmes analizës periodike dhe studimit marketing, pyetësorëve të hartuar nga institucioni drejtuar studentëve aktualë dhe palëve të tjera të interesuara si dhe takimeve të hapura me punëdhënës

<p>c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</p> <p>d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</p>	<p>potencialë.</p>
---	--------------------

Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.

Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;

Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.

Programi i studimit nuk bie ndesh me interesat kombëtare.

Programi i studimit synon ruajtjen e vlerave kulturore dhe kombëtare nëpërmjet lidhjes së teorisë me praktikën dhe karakteristikat e vendit tonë.

Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Kriteri 1 Programet e studimeve "Master i Shkencave" realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;

Ky kriter nuk zbatohet për këtë program studimi.

Kriteri 2 Programet e studimeve "Master Profesional" realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.

Programi i studimit "Master Profesional" në "Financë-Kontabilitet" i KU "LOGOS" parashikon 60 kredite (ECTS) dhe kohëzgjatje një vit akademik.

Kriteri 3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës "Master i Shkencave". Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).

Ky kriter nuk zbatohet për këtë program studimi.


Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.

Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;

Në takimin me studentët u konfirmua se ata informohen në ditën e parë të vitit akademik në lidhje me të gjithë elementët e programit të studimit, syllabuset e lëndëve/moduleve, rregulloret etj.

Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.

Gjithashtu studentët në lidhje me këta elementë kanë mundësi që të konsultohen vazhdimisht nëpërmjet faqes së internetit të KU "LOGOS", në Zyrën e Këshillimi të Karrierës, në konsultime me pedagogët dhe publikimeve të ndryshme letër të institucionit.



Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.

Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;

Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve "Master i Shkencave" janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.

GVJ konstaton se në rregulloren e këtij programi studimi sqarohet mënyra e diplomimit e cila parashikon edhe realizimin e një mikroteze me 5 kredite (ECTS).

Ky kriter nuk zbatohet për këtë PS.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Programi i studimit "Master Profesional" në "Financë-Kontabilitet" ofrohet në përputhje me misionin dhe qëllimin e KU "LOGOS", me planin strategjik të zhvillimit dhe rregulloret e këtij institucioni si dhe me kuadrin rregullator në fuqi. Ky program master bazohet në kurrikulën e bachelorit dhe është hartuar në përputhje me nivelin në të cilin ofrohet.
2. Programi master në shqyrtim bazohet në eksperiencat më të mira të universiteteve evropiane dhe vendase, me disa prej të cilave KU "LOGOS" ka nënshkruar edhe marrëveshje bashkëpunimi.
3. Syllabuset e këtij programi studimi i nënshtrohen rishikimit vit pas viti për të reflektuar sa më mirë nevojat e tregut të punës.
4. Programi i studimit në shqyrtim synon ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe ofron informacion të plotë në lidhje me çdo element të rëndësishëm të tij.

Për sa është shpjeguar më sipër, konkludojmë që standardet në çështjen 7 "Programi i studimit, organizimi i tij" përmbushen plotësisht.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Programi i studimit Master Profesional në Financë-Kontabilitet organizohet me kohë të plotë, gjatë një viti akademik dhe vlerësohet me 60 kredite ECTS. Format e mësimdhënies janë një kombinim i leksioneve, seminareve, testeve të ndërmjetme, detyrave të kursit, praktika profesionale dhe mikroteza. Ngarkesa mësimore është e shpërndarë në dy semestra me nga 15 javë për semestër. Kontrolli i njohurive kryhet nëpërmjet: testimit gjatë vitit dhe atij në fund viti, prezantimit të detyrave të kursit, si edhe aktivizimit të studentëve në seminare. Staf i akademik i anagazhuar në këtë program studimi është i kualifikuar brenda dhe jashtë vendit në përputhje me kërkesat e Ligjit për Arsimin e Lartë.

KU "LOGOS" ofron ambientet e nevojshme ku mund të përdoret teknologjia në funksion të mësimdhënies. Vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies kryhet nga njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë si dhe kordinatori i programit. Rezultatet e anketimeve/intervistave me studentët tregojnë për një nivel të kënaqshëm mësimdhënieje.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:

- Leksione
- Seminare
- Ushtrime
- Laboratore
- Praktikë lëndore
- Praktikë profesionale
- Etj

Tabela 8.1 në Aneksin në fund të këtij materiali përmbledh format e mësimdhënies sipas orëve të parashikuara në auditor.

Format e kontrollit të njohurive

Tabela 8.2 në Aneksin në fund të këtij materiali përmbledh format e kontrollit të njohurive.

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Viti akademik 2017-2018 është viti i fillimit për programin e studimit Master Profesional në "Financë-Kontabilitet" me 60 kredite në përputhje me kërkesat e ligjit 80/2015 dhe urdhërit të Ministrit nr 428 datë 22/09/2017 për riorganizimin e programit të studimeve të ciklit të dytë Master Profesional. Studentët ftohen të jenë pjesë e projekteve kërkimore-shkencore të iniciuara nga institucioni, por mungesa e eksperiencës si program studimi me 60 kredite ECTS dhe numri i vogël i studentëve në këtë program ka kushtëzuar angazhimin e tyre.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

- Ngarkesa e stafit akademik sipas orëve të parashikuara në programin e studimit.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Në rregulloren e programit Master Profesional në "Financë-Kontabilitet" përcaktohen procedurat e pranimit të studentëve në këtë program studimi. Konkretisht pranimi në këtë PS është i hapur për të gjithë kandidatët që plotësojnë kriteret e përcaktuar nga KU "LOGOS":

- Të kenë përfunduar një program studimi të ciklit të parë dhe të zotërojnë një diplomë universitare apo diplomë të huaj ekuivalente me të në fushën e financë-kontabilitetit ose në fusha të përafërta me këtë program.
- Të kenë rezultate akademike në nivelin e përcaktuar nga njësia që mbulon programin.
- Preferohen kandidatët që kanë përvojë pune dhe veçanërisht në fushat e lidhura me programin.
- Titujt pasuniversitarë kanë përparësi.
- Kandidatët duhet të zotërojnë aftësi të mira kompjuterike dhe të përdorimit të bibliotekave online.

Gjatë vitit akademik 2017-2018, që është dhe viti i parë i këtij programi studimi (në përputhje me kërkesat e ligjit 80/2015 dhe urdhërit të Ministrit nr 428 datë 22/09/2017 për riorganizimin e

programit të studimeve të ciklit të dytë Master Profesional) janë regjistruar 6 studentë nuk ka ende statistika finale lidhur me diplomimin dhe punësimin e tyre.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Procedurat e pranimit të studentëve KU "LOGOS" bën publike procedurat dhe kriteret e pranimit të studentëve në programin e studimit "Master Profesional" në "Financë-Kontabilitet" së bashku me dokumentacionin e nevojshëm. Mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur, bëhet radhitja dhe përzgjedhja e kandidatëve nga Departamenti i Financë Kontabilitetit.

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare Për vitin akademik 2017-2018, në këtë program studimi janë regjistruar 7 studentë por faktikisht e frekuentojnë vetëm 6 prej tyre. Nota mesatare e studentëve deklarohet 7.1/10.

Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare.

Duke qenë se viti akademik 2017-2018 është viti i parë i këtij programi studimi nuk ka ende statistika lidhur me diplomimin.

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend KU "LOGOS" ofron mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve, mes programeve të të njëjtit cikël studimi brenda Fakultetit të Ekonomisë apo institucione të arsimit të lartë në vend, vetëm në fillim të vitit akademik. Vendimi për njohjen e plotë apo të pjesshme të krediteve të fituara nga një student merret nga një komision i posaçëm i ngritur nga Departamenti i Financë-Kontabilitetit.

Të dhëna për punësimin e studentëve

Duke qenë se viti akademik 2017-2018 është viti i parë i këtij programi studimi me 60 kredite nuk ka ende statistika lidhur me punësimin e tyre.

Numri total të diplomuarve

N/A

Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

N/A

Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)

N/A

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	

Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve "Master i Shkencave" apo "Master Profesional" zotërojnë së paku diplomën universitare "Bachelor" dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;

Kriteri 2 Pranimit në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;

Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;

Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve "Master Profesional" niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve "Master i Shkencave" dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;

Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikën e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.

Studentët që ndjekin programin e studimit Master Profesional në "Financë-Kontabilitet" zotërojnë diplomën universitare të nivelit të parë, bachelor dhe kanë grumbulluar 180 kredite.

Ky kriter nuk zbatohet për këtë PS.

Studentët e programit të studimit Master Profesional në "Financë-Kontabilitet" plotësojnë kriteret e pranimit të vendosura nga institucioni në kornizën e tij rregullatore.

Për studentët e programit të studimit Master Profesional në Financë-Kontabilitet të KU "LOGOS", nuk është i detyrueshëm kriteri i gjuhës angleze për diplomim.

Kriteret e pranimit të studentëve janë të përcaktuara në rregulloren e këtij programi studimi, por ato kanë qenë pjesë e rishikimeve të vazhdueshme në varësi të ndryshimeve të kryera në legjislacionin e arsimit të lartë, kërkesave të tregut të punës apo përmirësimit të standardeve të cilësisë së institucionit.

Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikën e punësimit.

Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;

Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;

Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.

Në takimin me studentët dhe dokumentacioni i paraqitur GVJ konstatoi se studentëve ju jepet informacion për punësim pas diplomimit nëpërmjet Zyrës së Këshillimit të Karrierës, takimeve të hapura me përfaqësues të bizneseve dhe institucioneve me të cilat KU "LOGOS" ka lidhje. Informacionet afishohen nga këto zyra dhe në faqen eeb të institucionit.

Studentëve ju jepet informacion në lidhje me akreditimin e institucionit dhe të programeve të veçanta të studimit që ai ofron nga: Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe nga Zyra e Këshillimit të Karrierës. Këto njësi ofrojnë jo vetëm informacionin e mësipërm por edhe njohjen studentëve në lidhje me procedurat e njohjes dhe vlefshmërisë së diplomave brenda dhe jashtë vendit.

Studentëve ju ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës lidhur me mundësitë potenciale të punësimit nga Zyra e këshillimit të karrierës.

Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.

Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;

Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo

Viti akademik 2017-2018 është viti i parë i programit të studimit Master Profesional në "Financë-Kontabilitet" me 60 kredite ECTS.

Aktualisht për këtë program studimi disponohen të dhënat vetëm për 6 studentët e regjistruar gjatë këtij viti, të cilët janë në proces diplomimi. Studenti i shtatë i regjistruar nuk

<p>mospërfundimin me sukses të vitit akademik; Kriteri 3 Institucioni disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>ka frekuentuar por nuk është zyrtarisht cregjistruar ende nga programi i studimit. Në dokumentacionin dhe regjistrat e sekretarisë të dhënat ishin të përditësuara për secilin prej 6 studentëve të programit.</p>
--	--

Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikën e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.

<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre; Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>Viti akademik 2017-2018 është viti i parë i këtij programi studimi. KU "LOGOS" është i angazhuar në mbajtjen e një baze të dhënash të përshtatshme.</p>
--	---

Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.

<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit; Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit; Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Në takimin me studentët e programit të studimit Master Profesional në "Financë-Kontabilitet", GVJ konstatoi se ata informohen në lidhje me të gjitha detajet që kanë të bëjnë me procesin mësimor apo me elementë të tjerë ndihmës në funksion të këtij procesi. Kështu, ata informohen në lidhje me: programin e studimit, strukturën e vitit akademik, statusin e akreditimit të programit, rregulloret e programit të studimit, etj. Disa nga informacionet e mësipërme janë pjesë e faqes ëeb të KU "LOGOS" dhe guidës së studentit. Studentët informohen në lidhje me rezultatet e vlerësimit gjatë programit apo në përfundim të tij jo vetëm nga pedagogët por edhe nga sekretaria mësimore. Pedagogët e lëndës/modulit ju japin studentëve rezultatet e ndërmjetme apo ato përfundimtare në fund të semestrit. Të drejtat e studentëve në lidhje me këtë element përcaktohen edhe në rregulloren e programit të studimit (afatet, ankimimi, etj.).</p>
---	---

Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.

<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor; Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>KU "LOGOS" këshillon studentët në lidhje me procesin mësimor, mbi të gjithë elementët për të cilët studentët janë të interesuar, asiston studentët në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që ata hasin gjatë programit të studimit. Ky shërbim kryhet kryesisht, por jo vetëm, nga pedagogu këshillues që i caktohet grupit mësimor në fillim të çdo viti mësimor si dhe nga zyra e këshillimit të karrierës. Nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës, por jo vetëm, KU "LOGOS" ndihmon studentët të përzgjedhin institucionin ku do të zhvillojnë praktikën profesionale.</p>
---	---

Konkluzionet e vlerësimit:

1. KU "LOGOS" respekton legjislacionin në fuqi në lidhje me regjistrimet e studentëve

në programin e studimit Master Profesional në Financë-Kontabilitet.

2. Kriteret e pranimit në këtë program studimi janë të specifikuar në rregulloren e masterit të këtij programi studimi.
3. Institucioni informon studentët në lidhje me të gjithë elementët e nevojshëm për këtë program studimi.
4. Institucioni ka angazhuar personel të kualifikuar në përkujdesjen ndaj studentëve.

Për sa është shpjeguar më sipër, konkludojmë që standardet në çështjen 9 "Studentët" përmbushen plotësisht.

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Në shërbim të programit të studimit "Master Profesional" në "Financë-Kontabilitet" është edhe politika e kërkimit shkencor që ndjek KU "LOGOS" e shprehur në kuadrin rregullator të institucionit dhe e mbështetur nga struktura të posaçme si Qendra e Kërkimit Shkencor dhe Komiteti Shkencor i programit të studimit. KU "LOGOS" inkurajon dhe mbështet zhvillimin e punës kërkimore shkencore të pedagogëve në mënyrë individuale dhe në nivel institucional, si dhe angazhimin e studentëve në këto projekte. Aktualisht puna kërkimore është e organizuar në drejtim të:

- Rritjes së nivelit të mësimdhënies përmes përmirësimit të vazhdueshëm të kurrikulave mësimore.
- Formimit tekniko-profesional të studentëve në përgjigje të nevojave të tregut dhe nxitjes së prirjeve individuale të studentëve në sipërmarrje.
- Rritja e nivelit shkencor të pedagogëve përmes kualifikimeve, pjesëmarrjeve në konferenca të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, angazhimit në projekte të ndryshme profesionale të sipërmarrjeve private dhe publike.
- Forcimit të bashkëpunimeve të KU "LOGOS" me institucione të tjera vendase dhe të huaja nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit, binjakëzimeve dhe shkëmbimeve të eksperiencës në nivel stafi dhe studentësh.
- Rritjes së numrit të publikimeve në botime shkencore brenda dhe jashtë vendit në formën e teksteve mësimore, monografive, artikujve e botime të tjera në revista shkencore mbështetëse të programit.

Aktualisht KU "LOGOS" është i përfshirë në disa projekte kërkimore dhe nëpërmjet faqes ëeb dhe revistës "LOGOS" informon studentët dhe të gjithë të interesuarit në lidhje me kërkimet më të fundit të realizuara nga pedagogë të institucionit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për kërkimin shkencor
- Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL
- Numri i projekteve kërkimore të fituara
- Numri i projekteve të zbatuara
- Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL
- Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL
- Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor
- Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor
- Numri i Çmimeve Kombëtare

Numri i vogël i stafit të angazhuar me kohë të plotë në këtë program studimi si dhe mosha mesatare relativisht e re e tyre, bën që pjesëmarrja në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë IAL aktualisht të jetë e kufizuar por premtuese për të ardhmen. Bazuar në informacionin sipas viteve mbi kërkimin shkencor, GVJ vlerëson se angazhimi në aktivitete individuale dhe në rang institucioni në vitet e fundit ka ardhur në rritje. Aktualisht revista shkencore "LOGOS" botohet 2 herë në vit dhe personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi në 4 vitet e fundit ka realizuar 21 referime në konferenca shkencore (edhe me bashkëautorësi) dhe ka botuar rreth 15 artikuj në revista shkencore. Të gjithë studentët dhe pedagogët e këtij programi studimi janë të përfshirë në forma të ndryshme të kërkimit kryesisht të lidhura me procesin mësimor, përshkak dhe të numrit të vogël të studentëve në këtë program. Tabela 10.1 në Aneksin në fund të këtij materiali përmbledh të dhënat për kërkimin shkencor të personelit akademik të angazhuar pranë Fakultetit të Ekonomisë.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
 - Informacion sipas viteve mbi kërkimin shkencor

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse; Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe takimet e zhvilluara GVJ konstatoi se personeli akademik i programit të studimit Master Profesional në "Financë-Kontabilitet" publikon artikuj apo materiale të ndryshme shkencore si dhe merr pjesë në konferenca dhe aktivitete të tjera. Nëpërmjet angazhimit në veprimtari apo aktivitete të ndryshme shkencore personeli akademik i këtij programi studimi jep kontributin e tij në fushën e financës dhe kontabilitetit.
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	
Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj; Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në	Ky kriter nuk zbatohet për këtë program studimi. Ky kriter nuk zbatohet për këtë program studimi.

mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.

Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.

Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;

Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.

Nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit me universitete të huaja, KU "LOGOS" mundëson pjesëmarrjen e stafit në kualifikime afatshkurtra (trajnime, konferenca, shkolla vere). Gjatë vizitës në institucion u informuam që ishte në proces vendimmarrja nga Bordi i administrimit i KU "LOGOS" lidhur me fondin e secilit departament në funksion të kualifikimit dhe të kërkimit shkencor.

Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.

Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;

Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;

Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.

Bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe takimet e zhvilluara GVJ vlerëson se KU "LOGOS" disponon të dhëna për studime shkencore të personelit akademik të këtij programi studimi.

KU "LOGOS" disponon të dhëna për botimet shkencore brenda dhe jashtë vendit të personelit akademik të këtij programi studimi, si pjesë edhe e dosjes së personelit.

Mosha mesatare e pedagogëve të këtij programi është relativisht e re dhe angazhimet janë të lidhura me projektet më të fundit në të cilat është përfshirë KU "LOGOS". Qendra e Kërkimit Shkencor disponon të dhëna për projektet shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë aktualisht personeli akademik i këtij programi studimi.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Personeli akademik ka marrë pjesë në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare.
2. Një fokus të veçantë në këtë program studimi zë edhe kërkimi shkencor në funksion të përmirësimit të procesit të mësimdhënies.
3. KU "LOGOS" po punon për të nxitur dhe mbështetur financiarisht stafin akademik për pjesëmarrje në konferenca, trajnime, etj, të organizuara nga IAL apo institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit.
4. Institucioni disponon dokumentacion të plotë lidhur me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik.

Për sa është shpjeguar më sipër, konkludojmë që standardet në çështjen 10 "Kërkimi shkencor" përmbushen plotësisht.

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

KU "LOGOS" ka përcaktuar një politikë bashkëpunimi me partnerë vendas dhe të huaj në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Marrëveshjet kryesore të bashkëpunimit të lidhura me institucione shqiptare (si Universiteti Bujqësor i Tiranës, Universiteti "Zonja e Këshillit të Mirë etj), universitete të rajonit (si Universiteti i Maqedonisë Perëndimore) si edhe me universitete të tjera perëndimore (si Universiteti Sancti Cyrilli A.D. 1669) synojnë bashkëpunimin në fushën e edukimit, formimit tekniko-profesional, kërkimit shkencor dhe në fushat e tjera me interes të ndërsjelltë. Marrëveshjet janë në nivel institucioni por pritet që t'i shërbejnë konkretisht edhe këtij programi studimi përsa i takon kualifikimit të stafit dhe shkëmbimit të studentëve.

KU "LOGOS" ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe me komunitetin e biznesit dhe me aktorë të tjerë në tregun e punës, në funksion të konkretizimit të njohurive teorike të marra nga studentët gjatë këtij programi studimi dhe të zhvillimit të praktikave mësimore në fund të programit të studimit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar
 - Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare
 - Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj
 - Numri i pjesëmarrësve në trainime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit
 - Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL
 - Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor
 - Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime

Marrëveshjet e bashkëpunimit të lidhura me partnerë vendas dhe të huaj nga KU "LOGOS" janë në nivel institucioni. Numri i vogël dhe mosha mesatare relativisht e re e stafit të angazhuar në këtë program studimi bën që pjesëmarrja në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë IAL aktualisht të jetë e kufizuar por premtion për një zhvillim pozitiv në të ardhmen. Aktualisht stafi i KU "LOGOS" është pjesëmarrës në 5 projekte ndërkombëtare/kombëtare; ka realizuar 2 leksione me lektorë të huaj dhe ka realizuar 6 prezantime në aktivitete shkencore jashtë IAL-së. Tabela 11.1 në Aneksin në fund të këtij materiali përmbledh të dhënat për bashkëpunimin/angazhimin në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë:

- Institucionet qeveritare bashkëpunuese
- Organizatat Profesionale
- Komuniteti i biznesit, tregu i punës

Disa nga marrëveshjet e bashkëpunimit të lidhura nga KU "LOGOS" me institucionet e tjera shtetërore si psh Ministria e Ekonomisë dhe Turizimit, Bashkia Tiranë apo organizata profesionale si Shoqata Kombëtare e Turizimit (ATA) janë në nivel institucioni. Marrëveshjet me komunitetin e biznesit, të lidhura për realizimin e praktikave profesionale (rreth 7 të tilla) janë më të fokusuar në

nevojat e programit të studimit. Tabela 11.2 në Aneksin në fund të këtij materiali përmbledh të dhënat për bashkëpunimin me sipërmarrje dhe institucionet kombëtare.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
 - Tabela e përditsuar me të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
<p>Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p>Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>GVJ konstatoi se për kryerjen e praktikave profesionale në përfundim të programit të studimit KU “LOGO” ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me sipërmarrje, institucione dhe organizata të ndryshme si zyra konsulence financiare, banka, shoqëri sigurimi, shoqëri komunikimi dhe shoqëri të tjera tregtare.</p> <p>Ky Kriter nuk zbatohet për këtë program studimi.</p>
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Nga takimet e zhvilluara dhe dokumentacioni i paraqitur, GVJ vlerëson se KU “LOGOS” nxit bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit, ndërmjet personelit dhe hallkave institucionale brenda tij edhe në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të programit të studimit Master Profesional në “Financë-Kontabilitet”.</p> <p>KU “LOGOS” nëpërmjet ndarjes së detyrave dhe përgjegjësisë ndërmjet personelit dhe hallkave të ndryshme të institucionit, si dhe analizës së vazhdueshme të punës së gjithë secilit, garanton marrëdhënie të mira bashkëpunimi.</p>
Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të</p>	<p>KU “LOGOS” ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me IAL jashtë vendit (në rajon dhe më gjerë) si edhe me IAL vendase dhe institucione shqiptare për të realizuar objektivat e programeve të studimit të ofruara prej tij ku përfshihet dhe programi Master Profesional në “Financë-Kontabilitet”,</p> <p>KU “LOGOS” ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me: biznese financiare, shoqëri tregtare dhe shoqëri konsulente për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës profesionale të studentëve të programit pranë tyre.</p> <p>KU “LOGOS” bashkëpunon me punëdhënësit</p>

studimeve.


nëpërmjet takimeve dhe leksioneve të hapura.

Ky është viti i parë për programin e studimit Master Profesional në "Financë-Kontabilitet" dhe institucioni është në proces krijimi të një baze të dhënash të përshtatshme për të kryer një analizë të ecurisë së marrëveshjeve ekzistuese dhe të nënshkrimeve të reja të marrëveshjeve bashkëpunimit.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. KU "LOGOS" ka eksperiencë institucionale bashkëpunimi në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Zyra e marketingut e këtij institucioni është në kërkim të vazhdueshëm të realizimit të bashkëpunimeve të reja në funksion të programeve të studimit.
2. Bashkëpunimet me shoqëritë vendase të sektorëve financiarë, tregtarë apo prodhues, mundësojnë më së miri kryerjen e praktikave profesionale pjesë e këtij programi studimi.
3. Marrëveshjet e bashkëpunimit me universitet e huaja kryesisht në kuadër të programeve si ERASMUS janë një mundësi e mirë për kualifikimin e vijueshëm të stafit.

Për sa është shpjeguar më sipër, konkludojmë që standardet në çështjen 11 "Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun" përmbushen plotësisht.



ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR IMPLEMENTIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Analiza përmbledhëse e RVJ sipas metodës **SWOT** (Strengths-pikat e forta, Weaknesses- pikat e dobëta, Opportunities-mundësitë, Threats-pengesat).

a. Pika të forta:

- 1) Ofrimi i një cikli të plotë edukimi bachelor dhe master të të njëjtit profil, me programe bashkëkohore, duke synuar plotësimin në të ardhmen edhe me profile të reja;
- 2) Raporti i ulët studentë / pedagog mundëson një kontroll dhe vlerësim eficient të ecurisë mësimore dhe kërkimore të studentëve;
- 3) Infrastruktura bashkëkohore dhe kushte të mira për zhvillimin e procesit mësimor;
- 4) Tarifa studimi konkurruese në tregun e programeve me karakteristika të ngjashme;
- 5) Politikat e dhënies së bursave për studentët më të mirë dhe në nevojë.

b. Pika të dobëta:

- 1) Numri i ulët i studentëve të përfshirë në programin e studimit Master Profesional në "Financë-Kontabilitet";
- 2) Disa struktura të brendshme janë krijuar rishtaz dhe ndihet nevoja e formalizimit dhe e ndarjes së detyrave dhe përgjegjësisë;
- 3) Burime të kufizuara të periodikëve dhe teksteve në gjuhën shqipe në mbështetje të programit të studimit;
- 4) Përdorimi online i bibliotekës është i kufizuar vetëm në ambientet e KU "LOGOS";
- 5) Mungon një sistem i informatizuar informacioni veçanërisht për sekretarinë dhe bibliotekën.

c. Mundësitë:

- 1) Kërkesat në rritje të tregut të punës për profesionistë të specializuar në programin e studimit Master Profesional në "Financë-Kontabilitet";
- 2) Marrëveshjet e bashkëpunimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
- 3) Praktika e rishikimit/përditsimit vjetor të syllabuseve në funksion të nevojave të programit dhe tregut të punës;
- 4) Moshë e relativisht e re e stafit akademik premt për zhvillime pozitive në fushën e kërkimit shkencor si e pjesë dhe kërkesave për kualifikimin e vijueshëm.

5) Mbështetja financiare e vazhdueshme nga fondacioni "LOGOS".

d. Pengesat:

- 1) Konkurrenca në rritje nga programet e ngjashme të ofruara nga universitetet e tjera në vend dhe rajon;
- 2) Numri i kufizuar i studentëve, kufizon dhe nivelin e investimeve në funksion të programit të studimit;
- 3) Lëvizja e stafit akademik me kohë të plotë mund të rëndojë negativisht raportin e PAE/PAK.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. As. Dr. Etleva Bajrami

Dr. Valbona Kapllani



SUMMARY ANALYSIS FOR THE IMPLEMENTATION OF THE STUDY PROGRAMME

The report of the external evaluation (RVJ) concludes with "Summary analysis of RVJ" by SWOT method (Strengths, Weaknesses, Opportunities, Threats).

a. Strengths:

- 1) The University College "LOGOS" provides a full cycle studies, Bachelor's and Master's degrees of the same profile with contemporary programs, aiming to add more profiles in the future;
- 2) Low ratio of student versus overall academic staff enables a more efficient control and assessment of the students' performance and their research skills;
- 3) It has modern infrastructure and facilities for effective teaching and learning;
- 4) Competitive fee for students enrolled at study program in comparison to other programs with similar characteristics of other universities;
- 5) Policy of granting scholarships to the best students and in need, for students enrolled at all study programs.

b. Weaknesses:

- 1) Low number of students enrolled at the Master's Professional study program in "Finance-Accounting";
- 2) Some internal structures are newly created and there is a need for formalization and separation of duties and responsibilities.
- 3) Limited sources of periodicals and texts in Albanian language in support of the study program;
- 4) The library's online use is limited only to the premises of UC "LOGOS";
- 5) There is a lack of information system especially for secretarial and library.

c. Opportunities:

- 1) Increased job market demands for professionals specialized in Master's Professional study program in "Finance-Accounting";
- 2) Cooperation agreements at national and international level;
- 3) The reviewing / updating annually of syllabuses in function of study program and job market needs;
- 4) The relatively young age of academic staff promises for positive developments in the field of research as part of requirements for their continuing qualification as well;
- 5) Continuous financial support from the foundation "LOGOS".

d. Threats:

- 1) Growing competition from similar programs offered by other universities in the country and the region;
- 2) The limited number of students restricts the amount of investments in support of the study program;
- 3) Full-time academic staff movement may adversely affect the PAE/PAK ratio.

External Evaluation Team:

Prof. As. Dr. Etleva Bajrami



Dr. Valbona Kapllani



ANEKS

Tabela 3.1: Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK) në Fakultet

Fakulteti Ekonomik	Numri i PAE		Numri i PAK		Në Total	
	Gj	Tituj/Grada	Gj	Tituj/Grada	Gj	Tituj/Grada
Departamenti Financë-Kontabilitet	7	3	2	2	9	5
Departamenti Menaxhim Biznesi	6	3	-	-	6	3
Departamenti Menaxhim Turizmi	7	3	2	2	9	5

Tabela 3.2: Lista e Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK)

Fakulteti Ekonomik							Departamenti Financë-Kontabilitet						
Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)		Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time						
1	Beatrice Polo	P/Depart	Prof.as.Dr	1	Ilir Tomorri	Prof.as.Dr	UBT						
2	Jehona Gjermizi	Lektor	Doktor	2	Elona Keci	Doktor	UBT						
3	Soniela Grazhdani	Lektor	Doktor										
4	Elvis Xhori	As.Lektor	Msc										
5	Blerin Banushi	As.Lektor	Msc										
6	Klejda Gabeshi	As.Lektor	Msc										
7	Iva Sulaj	As.Lektor	Msc										
Fakulteti Ekonomik							Departamenti Menaxhim Biznesi						
Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)		Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time						
1	Parashqevi Draci	P/Depart	Doktor	-	-								
2	Bashkim Berberi	Lektor	Doktor										
3	Kejda Nuhu	Lektor	PhD										
4	Enida Abazi	As.Lektor	Msc										
5	Anisa Balla	As.Lektor	Msc										
6	Irena Papingji	As.Lektor	Msc										
Fakulteti Ekonomik							Departamenti Menaxhim Turizmi						
Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)		Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time						
1	Guxim Kola	P/Depart	PhD	1	Elton Noti	Prof.as.Dr	UAMD						
2	Bledar Ilia	Lektor	PhD	2	Brunilda Licaj	Doktor	UAMD						
3	Blerta Avdia	Lektor	Doktor										
4	Kosta Dovolis	Lektor	PhD										
5	Aida Zoto	As.Lektor	Msc										
6	Enxhi Marku	As.Lektor	Msc										
7	Denajda Cibuku	As.Lektor	Msc										

Tabela 3.3: Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinatorit/ët e programit të studimit

Emër Mbiemër	Titulli/grada	Pozicioni në Këshillin shkencor
Beatrice Polo	Prof.as.Dr	Anetare
Jehona Germizi	Doktor	Kordinatore e programit
Soniela Grazhdani	Doktor	Anetare

Tabela 3.4: Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre për stafin akademik të programit të studimit

Stafi akademik për programin e studimit "Master Profesional" në Financë-Kontabilitet							
Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)		Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time
1	Beatrice Polo	P/Depart	Prof.as.Dr	1	Ilir Tomorri	Prof.as.Dr	UBT
2	Soniela Grazhdani	Lektor	Doktor				
3	Jehona Gjermizi	Lektor	Doktor				
4	Guxim Kola	Lektor	PhD				
5	Kejda Nuhu	Lektor	PhD				

Titulli	Stafi akademik për programin e studimit		
	PAE	PAK	Raporti PAE/PAK
Profesorë	-	-	-
Profesorë të As.	1	1	1/1
Doktorë	4	-	5/0
Docentë	-	-	-
Pedagogë në proces DR	-	-	-
Asistentë me Ma	-	-	-
Personeli Administrativ	2	-	2/0

Tabela 5.1: Të ardhurat dhe shpenzimet (në përqindje) - periudha 2015-2017

Të ardhurat nga:	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017
Pushteti qendror			
Pushteti vendor			
Fonde jopublike:			
Grantet për kërkim dhe kontratat			
Konsulencat, shërbimet			
Tarifat për dhe gjatë shkollimit	68.85%	78.99%	67.54%
Sponsorizimet			
Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)			
Donacionet, aktivitetet siguroese, fondacione etj	31.15%	21.01%	32.46%
Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)			
Të tjera (qira, ndryshime kursi valutor, interesa bankare)			
Gjithsej	100%	100%	100%

Shpenzimet për vitin akademik:	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017
Paga e sigurime	77.63%	85.09%	82.59%
Shpenzime operacionale	6.52%	7.39%	10.26%
Shpenzime infrastrukture e amortizime	15.85%	7.52%	7.15%
Gjithsej	100.00%	100.00%	100.00%

Tabela 6.1: Të dhëna për anëtarët e NJSBC

	Anëtarët e NJSBC	Detyra që ka në NJSBC	Sa kohë ka në këtë detyrë
1	Arjola Rama	Kryetar	3.5 vjet
2	Kostandinos Giakoumis	Ekspert i jashtëm	2 muaj
3	Xhezmije Palushi	Anëtar	2 vjet
4	Gazmira Brahushi	Anëtar	1 vit
5	Denajda Cibuku	Anëtar	1 vit
6	Student	Anëtar	1 vit

Tabela 6.2: Të dhëna për anëtarët e NJSBC vetëm për Fakultetin Ekonomik, ngritur në 08.02.2018.

	Anëtarët e NJSBC	Detyra që ka në NJSBC	Sa kohë ka në këtë detyrë
1	Kejda Nuhu	Kryetar	4 muaj
2	Blerina Banushi	Anëtar	4 muaj
3	Enida Abazi	Anëtar	4 muaj
4	Student	Anëtar	4 muaj
5	Student	Anëtar	4 muaj

Tabela 7.1: Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

VITI I	Lëndë/Module	Semestri	ECTS	Orë mësimore											Gjithsej	Provime	
				Leksione			Seminare			Praktikë			Orë në auditor	Punë e Pavarur			
				ECTS	Në auditor	Punë e pavarur	ECTS	Në auditor	Punë e pavarur	ECTS	Në auditor	Punë e pavarur					
1	Taksim	II	6	4	3	30	45	3	30	45				60	90	150	1
2	Drejtim financiar i avancuar	I	6	4	3	30	45	3	30	45				60	90	150	1
3	Buxheti dhe analiza financiare	I	5	4	3	30	45	2	30	30				60	65	125	1
4	Kontabilitet financiar I avancuar	I	6	4	3	30	45	3	30	45				60	90	150	1
5	Teoria dhe drejtimi I portofolit	I	6	4	3	30	45	3	30	45				60	90	150	1
6	Tregjet dhe institucionet financiare	I	6	4	3	30	45	3	30	45				60	90	150	1
7	Menaxhim strategjik dhe I burimeve njerezore	I	5	4	3	30	45	2	30	20				60	65	125	1
8	Historia ekonomike dhe politike evropiane / Sistemi monetar evropian	I	5	4	3	30	45	2	30	20	5	100	25	100	25	125	1
9	Praktikë profesionale	II	5											50	200	250	
10	Mikroteza	II	10											630	870	1500	
	Totali		60			24	240	360	21	240	295						

Tabela 7.2: Ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

PLANI MËSIMOR MASTER PROFESIONAL NË FINANCË-KONTABILITET			
Tipi i Veprimtarisë	Lënda/Moduli	Kreditet	Totali
A. Disiplina të formimit të përgjithshëm	Teori dhe drejtim portofoli	6	12
	Tregjet dhe institucionet financiare	6	
B. Disiplina të formimit karakterizues të programit	Taksim	6	23
	Drejtim financiar I avancuar	6	
	Kontabilitet financiar i avancuar	6	
	Buxhetimi dhe analiza financiare	5	
C. Disiplina formuese të ngjashme dhe/ose integrale	Menaxhim strategjik I burimeve njerezore	5	5
D. Veprimtari në disiplina me zgjedhje	Lende me zgjedhje 1 - Historia ekonomike-politike evropiane	5	5
	Lende me zgjedhje 2 - Sistemi monetar evropian	5	
E. Njohuri të tjera formuese si plotësime në gjuhët e huaja, informatikë, stazh, apo praktika		5	5
	Praktikë profesionale	10	10
F. Teza e diplomës	Mikroteza	60	60
	TOTALI		

Tabela 7.3: Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës

Lënda /Moduli	Pedagogu/Pedagogët Përgjegjës	Titulli/grada kualifikimi	Departamenti	Statusi PAE apo PAK
1 Taksim	Ilir Tomori	Prof. As. Dr.	Financë-Kontabilitet	PAK
2 Drejtim financiar i avancuar	Soniela Grazhdani	Doktor	Financë-Kontabilitet	PAE
3 Buxhetimi dhe analiza financiare	Ilir Tomori	Prof. As. Dr.	Financë-Kontabilitet	PAK
4 Kontabilitet financiar I avancuar	Jehona Gjermizi	Doktor	Financë-Kontabilitet	PAE
5 Teoria dhe drejtimi I portofolit	Guxim Kola	PHD	Financë-Kontabilitet	PAE
6 Tregjet dhe institucionet financiare	Guxim Kola	PHD	Financë-Kontabilitet	PAE
7 Menaxhim strategjik dhe I burimeve njerezore	Kejda Nuhu	PHD	Menaxhim Biznesi	PAE
8 Historia ekonomike dhe politike evropiane	Kejda Nuhu	PHD	Menaxhim Biznesi	PAE

Tabela 8.1: Llojet e Formave të mësimdhënies

Programi i Studimit: MASTER PROFESIONAL NË FINANCË-KONTABILITET		
Format e mësimdhënies		Orët totale në auditor
a.	Leksione	240
b.	Seminare	240
c.	Ushtrime	-
d.	Laboratore	-
e.	Praktikë lëndore	-
f.	Praktikë profesionale	100
g.	Prova finale	50
Në total		630

Tabela 8.2: Format e kontrollit të njohurive

Format e kontrollit të njohurive	Pjesa (në %) ndaj totalit
Ndjekja e lëndës dhe pjesmarrja aktive	10%
Plotësimi i detyrimeve (detyra kursi)	10%
Testimet gjatë vitit	30%
Provimi përfundimtar	50%
Etj	
Në total	100%

Tabela 10.1: Të dhëna për kërkimin shkencor

Aktivitete të planifikuara individuale dhe në rang Institucioni në vitet e fundit		
1	Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL	28 referime në konferenca shkencore, apo me bashkautorësi (6 në vit); 4 numra të revistës shkencore "LOGOS" - dy në vit; 18 artikuj të botuar në revista shkencore, brenda e jashtë vendit (4 në vit).
2	Numri i projekteve kërkimore të fituara	3 projekte të fituara, në të cilat janë përfshirë pedagogë të Fakultetit Ekonomik.
3	Numri i projekteve të zbatuara	1 projekt i zbatuar
4	Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL	5 aktivitete të organizuara (1-2 në vit)
5	Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL	Të gjithë studentët dhe pedagogët e këtij programi janë përfshirë në aktivitetet shkencore brenda IAL.
6	Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor	Të gjithë studentët dhe pedagogët e këtij programi janë përfshirë në forma të ndryshme në kërkimin shkencor
7	Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor	N/A
8	Numri i Çmimeve Kombëtare	-




Tabela 11.1: Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar

MARRËVESHJE ME UNIVERSITETE TË HUAJA	
Universiteti I Pireut	Greqi
Universiteti I Maqedonise Perendimore	Greqi
Universiteti Sancti Cyrilli A.D. 1669	Malta
Universiteti I Oradea	Rumani

MARRËVESHJE ME UNIVERSITETE DHE SHKOLLA SHQIPTARE	
Unversiteti Bujqesor I Tiranes	Memorandum bashkepunimi
Universiteti "Zonja e Keshillit te Mire"	Memorandum bashkepunimi
Shkolla Teknike Ekonomike Tirane	Memorandum bashkepunimi
Gjimnazi "Aleks Buda" Tirane	Memorandum bashkepunimi
Gjimnazi "Eqerem Cabej" Tirane	Memorandum bashkepunimi

Tabela 11.2: Të dhënat për bashkëpunimin me sipërmarrje dhe institucionet kombëtare

Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese	
Institucionet qeveritare bashkëpunuese:	Lloji i bashkëpunimit
Ministria e Ekonomise dhe Turizimit	Projekti Nderkombetar "EcoDestination"
Bashkia Tirane	Praktike Profesionale e studenteve
Organizatrat Profesionale:	
Shoqata Kombetare e Turizimit (ATA)	Praktike Profesionale e studenteve
Komuniteti i biznesit, tregu i punës	
Banka Kombetare Greke - NBG	Praktike Profesionale e studenteve
Shoqeri konsulence - Finance Partners	Praktike Profesionale e studenteve
Shoqeri konsulence - Shembtiraku	Praktike Profesionale e studenteve
Intersig Vienna Insurance Group sh.a.	Praktike Profesionale e studenteve
Telecom Albania	Praktike Profesionale e studenteve
Shoqeria tregtare Neranxi shpk	Praktike Profesionale e studenteve
Shoqeria Alumil Albania	Praktike Profesionale e studenteve
Instituti I Modelimeve ne Biznes	Ekspertize per kurrikulen mesimore.